

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6086
E enjte, 13 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Osmani: Ushtria e Kosovës,
shembull i profesionalizmit
dhe besueshmërisë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI | FAQE 4-5

NËSE LV-ja DHE PDK-ja PAJTOHEN, AKR-ja E SHQYRTON SERIOZISHT MOCIONIN



Kryetari i Kuvendit i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se qëndrimi i kësaj partie për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë varet prej dy partive më të mëdha

opozitare. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se nëse LV-ja dhe PDK-ja merren vesh për mocionin, atëherë edhe AKR-ja do ta shqyrtojë seriozisht këtë çështje.

Matoshi ka treguar se kjo parti politike ka pasur dhe ka oferta për t'u bërë pjesë e qeverisë. Sipas tij, AKR-ja bëhet pjesë e ekzekutivit vetëm në një qeveri gjithëpërfshirëse

OPINION

LIGJI PËR MBROJTJEN E
VLERAVE TË LUFTËS DHE
ARGATËT ANTI-UÇK,
ANTI-KOSOVË DHE ANTI-SHBA

F. 11

Shkruan:
Hisen BERISHA



AKTUALE



HALITI: KOSOVËS I DUHET NJË
KOALICION I MADH | F. 5



NË AAK KËRKOJNË QË
HARADINAJ TË JETË KANDIDAT
PËR PRESIDENT | F. 6

NGA 1 SHTATORI NXËNËSIT E
KLASAVE I DHE II IU KTHEHEN
BANKAVE SHKOLLORË | F. 6

EKONOMI

ZGJATET DERI MË 28 GUSHT
AFATI PËR APLIKIM PËR PAGESA
DIREKTE | F. 6

NESËR SHQYRTOHET
PROJEKTLIGJI PËR
RIMËKËMBJEN EKONOMIKE | F. 8

MIRATOHET LISTA
E DËSHMITARËVE PËR
PROCESIN E PRIVATIZIMIT | F. 9

HOTI KËRCON SIGURI DHE TRANSPARENCË GJATË TËRHEQJES SË MJETEVE NGA TRUSTI



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar nga drejtuesit e Trustit që aspektet teknike dhe procedurat e tërheqjes së mjeteve të jenë të sigurta dhe transparente për qytetarët, të cilët dëshirojnë t'i tërheqin mjetet e tyre.

Ndërsa ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se është angazhuar që procesi i tërheqjes së këtyre mjeteve të jetë i thjeshtë dhe pagesat të kryhen sa më shpejt, pas kalimit të Ligjit për rimëkëmbjen ekonomike në Kuvendin e Kosovës | FAQE 2

11 TË VDEKUR E 205 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princasha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sela: E çmojmë tryezën e përbashkët të partive politike

SHKUP, 12 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, pas takimit të realizuar me kryetarin e Alternativës, Afrim Gashi, ka folur në lidhje me ftesën e liderit të BDI-së, Ali Ahmeti, për takim të liderëve shqiptarë. Ai ka thënë se tryeza ka simbolikën e simbolikave të barabarta të të gjithë atyre që ulet dhe, sipas Selës, ajo që ka deklaruar Ahmeti ishte nënvlerësuese ndaj vetë instrumentit politik. Sela ka shtuar se në momentet më të rëndësishme kur ka qenë e nevojshme të ulet në tavolinë me liderët shqiptarë kjo nuk ka ndodhur. Sela ka thënë se tryeza

politike ka për qëllim strategjinë politike të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut në plane më afatgjata. Moment si ky ka qenë ndryshimi i Kushtetutës dhe nëse kjo do të funksiononte, gjuha shqipe në Kushtetutë do të ishte gjuhë shqipe dhe jo gjuhë që e flasin 20 për qind e popullsisë. "Ne kishim një takim të zakonshëm me Gashin. Natyrisht që ne e çmojmë instrumentin politik që është tryeza e përbashkët e partive politike dhe, si i tillë, është i rëndësishëm. Ky instrument politik do të duhej të ishte i shtrenjtë dhe i çmuar për shqiptarët dhe jo pjesë e



kalkulimeve politike të dikujt. Do të informoheni në lidhje me këtë çështje ditën e nesërme. Ne e respektojmë një instrument të tillë dhe nuk e llogarisim të mos bie objekt i rrjeteve sociale", ka

deklaruar Sela. Në lidhje me deklaratën e Ahmetit, ku ai i ka quajtur partitë e tjera politike të vogla, Sela ka theksuar: "Aty shihet vogëlsia e tij. Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa nuk mund të cilësohen me këto cilësime. E dëgjova që e pat këtë edhe në kontekstin e tryezës dhe më vjen keq që në pyetjen e drejtuar nga gazetarët ai nënvlerësoi edhe tryezën duke e quajtur si thirrje nën presion, nuk e di kush i ka bërë presion, në qoftë se e ka pasur fjalën për ndonjë parti tjetër të vogël nuk e di, do të duhet vetë të prononcohet".

Zaevi pritët ta marrë sot mandatin për formimin e qeverisë

SHKUP, 12 GUSHT - Presidenti i Maqedonisë, Stevo Pendarovski, sot (enjte) pritët t'ia japë mandatin për formimin e qeverisë kryetarit të LSDM-së, Zoran Zaev, partia e të cilit, si pjesë e koalicionit "Mundemi", ka marrë më shumë mandate në zgjedhjet e 15 korrikut. Nga kabineti i presidentit kanë thënë se Zaevi e ka njoftuar presidentin Pendarovski se është duke negociuar me shumë parti për formimin e qeverisë së re, raporton "Alast-M". Ndërkohë, presidenti i shtetit të mërkurën nëpërmjet një komunikate për media ka njoftuar se janë shuar të gjitha mëdyshjet sa i takon konstituimit të Kuvendit.

Deklaratave të bëra ditë më parë nga kryeparlamentari në largim, Talat Xhaferi, si dhe nga deputetja e VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska, se Kuvendi ende nuk është konstituuar, kabineti i presidentit është kundërpërgjigjur se në konsultim me ekspertë të fushës, kanë konstatuar se Kuvendi të llogaritet i konstituuar dhe se nevojitet vetëm verifikim i mandateve të deputetëve, e jo zgjedhja e dikujt. Nga Presidenca kanë thënë se këtë e dëshmojnë edhe praktikatat në vitet e kaluara, kur në pushtet kanë qenë parti të ndryshme, më konkretisht me dokumentet për njoftim të



presidentit nga ish-kryeparlamentari Trajko Veljanovski në vitin 2016, si dhe nga Stojan Andov në vitin 2006. "Esenca e pjesëmarrjes në zgjedhje është që dikush nga subjektet politike të arrijë në pozitë për të konstituuar pushtet, kështu që presidenti pret që në afat prej 10 ditëve nga

konstituimi i Kuvendit ta ndajë mandatin për kandidatin e partisë ose partive që kanë shumicë në Kuvend", ka njoftuar Presidenca. Ndërsa LSDM-ja është shprehur e bindur se Zoran Zaev do të jetë mandatar i qeverisë së ardhshme katërvjeçare. "Në vijim janë negociata serioze për formimin e shumicës parlamentare stabile dhe koalicionit qeverisës me mandat stabil dhe të plotë katërvjeçar. Për shkak se politikatat e suksesshme të LSDM-së dhe qeverisë që e udhëhoqi u dëshmuar edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare", ka njoftuar LSDM-ja.

Kryetari i Tiranës shërohet nga Covidi

TIRANË, 12 GUSHT (ER) - Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, pas dy javësh është shëruar nga koronavirusi. Lajmin e ka bërë me dije vetë Veliaj në një shkrim publikuar në "Facebook": "Pas dy javësh izolim e trajtim mjekësor, në Tiranë, e askund tjetër, testi i fundit më nxori të shëruar nga Covid-19, e më të fortë se kurrë për t'iu rikthyer punëve të shumta të kryeqytetit tonë. E kam zemrën plot mirënjohje për familjen time të vogël, Ajola, Kajan dhe nënat e papërtuara, e për familjen e madhe të mijëra prej jush, që më dhatë përditë kurajë e frymëzim për ta mundur këtë flamë. Do të kish qenë edhe më

e vështirë pa këmbënguljen e Ogertës, Albanës, Eugenës e Almes nga ISHP-ja të cilat më këshilluan ta merrja seriozisht që në fillim, pa përkushtimin 24h të doktor Perlatit apo injeksionet pupël të infermiere Adelinës, si dhe insistimit ditor të shokut Gramoz për t'iu bindur profesionistëve heronj e jo gjithologëve mendjehetë!", ka shkruar Veliaj. Ai ka thënë se gjatë këtyre dy javëve është miqësuar me plot pacientë apo të shëruar të tjerë. "Njoha historitë e tyre e ndamë momente të kësaj lufte të përbashkët të njerëzimit. Ky komunitet, ku tani edhe unë duhet ta bëj pjesën time, do të duhet të jetë më aktiv për t'i



ndërgjegjësuar të tjerët mbi seriozitetin e kësaj drame e nevojën për të bashkëpunuar me autoritetet çdo ditë! Jam i

lutem për familjet që lanë pas, e siç ua kam dëshmuar një pjesë prej tyre, do të angazhohem me gjithçka mundem për ta lehtësuar sadopak dhimbjen e nevojat e tyre, sidomos të fëmijëve!", ka shkruar ai, duke kërkuar nga shqiptarët që ta duan njëri-tjetrin më shumë. "Ndaj miq, le të duhemi më shumë e të urrehemi më pak. Të ndihmojmë më shumë e të shajmë më pak. Të bashkohemi më shumë e të përçahemi më pak! Nëse i bëjmë këto e bashkëpunojmë me bluzat e bardha, do të ngrihemi më të pjekur e më të fortë si komb! Unë besoj! Mirënjohje e dashuri pafund për secilin prej jush!", ka shkruar Veliaj.

Brenda 24 orëve të fundit janë testuar gjithsej 521 mostra për Covid-19

11 të vdekur dhe 205 raste të reja me Covid në Kosovë



Kosova vazhdon të përballet me shifra të larta të vdekjeve dhe të të infektuarve nga koronavirusi. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit kanë vdekur 11 persona, janë regjistruar 205 raste të reja me Covid-19 dhe janë shëruar 163 pacientë

Licencohen edhe 9 laboratorë privatë për kryerjen e testeve për Covid-19

Bordi për licencim të institucioneve shëndetësore private në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) ka vazhduar trajtimin e kërkesave për licencimin e shërbimit të testeve për SARS Cov-2. Nga aplikacionet e shqyrtuara në vijim, janë licencuar edhe 9 ISHP për kryerjen e testeve serologjike për SARS Cov-2. Më herët, Ministria e Shëndetësisë (MSh) kishte licencuar edhe 29 laboratorë të tjerë. Këta laboratorë do të monitorohen në vazhdimësi nga MSh-ja dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) lidhur me dallaveret e mundshme me çmimet.



ShSKUK-ja dhe FSSHK-ja diskutojnë për zbatim të vendimit të qeverisë

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka takuar të mërkurën drejtuesit e Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK). Në takim është diskutuar në lidhje me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për

pagesën shtesë prej 300 eurove për punëtorët shëndetësorë për muajin korrik dhe gusht. Krasniqi ka njoftuar drejtuesit e FSSHK-së në lidhje me hapat që ka ndërmarrë ShSKUK-ja për zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se ka formuar një komision, i cili do të punojë në këtë drejtim, për çka u pajtuan edhe drejtuesit e FSSHK-së. "Komisioni do të punojë ngushtë me drejtorët e klinikave të QKUK-së dhe njësitë e tjera përbërëse të ShSKUK-së, me

qëllim të eliminimit të keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve. Menaxhmenti i ShSKUK-së siguron të gjithë punëtorët se nuk ka dorëzuar listë me punëtorët, që iu takon kjo shtesë në ministrinë përkatëse, deri në përfundim të punës së komisionit", është thënë në njoftimin e ShSKUK-së. Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka falënderuar personalin shëndetësor të Kosovës për punën që po bëjnë gjatë pandemisë. "Më shumë se 13 000 mjekë, infermierë, personel shëndetësor dhe staf mbështetës gjithandej në luftë kundër pandemisë Covid-19. Faleminderit!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari në detyrë i Podujevës infektohet me Covid

Kryetari në detyrë i Podujevës, Nexhmi Rudari, është infektuar me koronavirus. Lajmin e ka bërë me dije vetë Rudari, i cili ka thënë se është mirë me shëndet. "Pas dyshimeve dhe qëndrimit disaditorë në vetizolim, jam testuar për Covid-19. Nga IKShPK sot më është konfirmuar se kam rezultuar pozitiv. Me shëndet jam shumë mirë dhe nuk kam asnjë lloj shqetësimi shëndetësor", ka shkruar Rudari në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 GUSHT - Trendi i shifrave të larta të vdekjeve nga koronavirusi, krahasuar me numrin e popullsisë, po vazhdon tash e disa javë në Kosovë. Edhe të mërkurën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit kanë vdekur 11 persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Përkundër masave kundër pandemisë të ndërmarra nga institucionet e Kosovës, as numri i të infektuarve nuk po ulet. IKShPK-ja ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 205 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 163 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 521 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 205 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 10.795

raste nga 42 136 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 365 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 163 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 6 411 raste, kurse numri i rasteve aktive është 4 019", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sikurse deri me tani, edhe në 24 orët e fundit prin Prishtina me numrin më të lartë të të infektuarve, me gjithsej 45 raste. Pastaj numrin më të madh të të infektuarve e ka Komuna e Gjilanit 20 raste, komuna e Ferizajt 17 raste, komuna e Mitrovicës 16 raste, komuna e Prizrenit 16 raste, komuna e Pejës 12 raste, komuna e Podujevës 12 raste, komuna e Gjakovës 7 raste, komuna e Fushës Kosovë 6 raste, komuna e Lipjanit 6 raste, komuna e Vitisë 6 raste, komuna e Vushtrrisë 6 raste, komuna e Drenasit 5 raste, komuna e Kaçanikut 5 raste, komuna e Obiliqit 5 raste, komuna e Malishevës 4 raste, komuna e Rahovecit 4 raste, komuna e Skenderajit 4 raste, komuna e Istogut 3 raste, komuna e Suharekës 2 raste dhe me nga një rast komuna Deçan, Kamenicë, Klinë dhe Shtërpçë.

Flet për “Epokën e re”, Fatmir Matoshi

Nëse LV-ja dhe PDK-ja pajtohen, AKR-ja e sh



Kryetari i Kuvendit i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se qëndrimi i kësaj partie për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë varet prej dy partive më të mëdha opozitare. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se nëse LV-ja dhe PDK-ja merren vesh për mocionin, atëherë edhe AKR-ja do ta shqyrtojë seriozisht këtë çështje. Matoshi ka treguar se kjo parti politike ka pasur dhe ka oferta për t’u bërë pjesë e qeverisë. Sipas tij, AKR-ja bëhet pjesë e ekzekutivit vetëm në një qeveri gjithëpërfshirëse

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 GUSHT - Kryetari i Kuvendit i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka treguar se kjo parti politike ka pasur dhe ka oferta për t’u bërë pjesë e qeverisë. Ai ka deklaruar se qëndrimi i kësaj partie është që nga pozicioni opozitar t’i mbështesë proceset që janë në interes për vendin. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Matoshi ka bërë me dije se AKR-ja bëhet pjesë e ekzekutivit vetëm në një qeveri gjithëpërfshirëse. “AKR-

ja ka pasur dhe vazhdon të ketë ofertë që të jetë pjesë e qeverisë. Ka qenë vendimi ynë që të rrimë në opozitë dhe t’i mbështesim proceset nga aty. E kemi votuar qeverinë Kurti dhe atë Hoti për t’u dhënë mbështetje atyre. Jemi pro përfshirjes në qeveri nëse arrihet një marrëveshje që të kemi një qeveri gjithëpërfshirëse ose në bazë të gjerë, këtë mundësi nuk e përjashtojmë”, ka thënë Matoshi. Duke komentuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të iniciuar nga LV-ja, ai ka thënë se votat e kësaj parti

për mocionin varen nga marrëveshja e LV-së me PDK-në.

Sipas Matoshit, nëse LV-ja dhe PDK-ja merren vesh për mocionin, atëherë edhe AKR-ja do ta shqyrtojë seriozisht këtë çështje. “Ende nuk i kemi parë detajet e mocionit të nisur nga Lëvizja Vetëvendosje. E vlerësojmë bashkëpunimin e mundshëm të partive opozitare LV e PDK dhe në rast se dy partitë merren vesh për mocionin, atëherë edhe ne do ta shqyrtojë seriozisht”, ka deklaruar ai.

Ai ka deklaruar se këto subjekte

politike duhet t’i përcaktojnë edhe hapat pas mocionit të mosbesimit. “Ky mocion duhet qartë të përcaktojë edhe hapat pas tij. Jemi në mes të pandemisë dhe subjektet politike që ishin kundër zgjedhjeve duhet ta argumentojnë fuqishëm idenë për zgjedhje të reja në këtë kohë”, është shprehur Matoshi. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Sipas Matoshit, dialogu në mes të këtyre dy shteteve duhet të zhvillohet pas marrëveshjes përfundimtare. “Ne kemi nevojë për një marrëveshje të shpejtë me të cilën Serbia detyrohet ta njohë shtetin e Kosovës fillimisht, pastaj të zhvillohet një dialog që duhet të fokusohet në ekonomi dhe çështje të tjera. Rikthimi i dialogut në tema të veçanta në Bruksel nuk garanton marrëveshjen finale. Është shumë e nevojshme që të ketë përfshirje dhe rol udhëheqës të ShBA-së në dialog”, ka thënë Matoshi.

“Epoka e re”: Z. Matoshi, Lëvizja Vetëvendosje ka nisur mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. A e perkrah AKR-ja kete mocion?

Matoshi: Ende nuk i kemi parë detajet e mocionit të nisur nga Lëvizja Vetëvendosje. E vlerësojmë bashkëpunimin e mundshëm të partive opozitare LV e PDK dhe në rast se dy partitë merren vesh për mocionin, atëherë edhe ne do ta shqyrtojë seriozisht. Ky mocion duhet qartë t’i përcaktojë edhe hapat pas tij. Jemi në mes të pandemisë dhe subjektet politike që ishin kundër zgjedhjeve duhet ta argumentojnë fuqishëm idenë për zgjedhje të reja në këtë kohë.

“Epoka e re”: Cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të qeverisë Hoti?

Matoshi: Qeveria kryesisht është duke u fokusuar në menaxhimin e situatës me Covid-19 dhe për këtë nevojitet mbështetje nga të gjithë. Jetët e

qyrton seriozisht mocionin

njerëzve dhe ekonomia jonë po rrezikohen përditë. Është një situatë më serioze sesa që po vlerësohet. Janë disa veprime jo të mira të kësaj qeverie. Po e zëmë, në të njëjtën ministri emërohen deri në tre zëvendësministra nga një parti politike. Edhe në qeverinë Haradinaj kjo ishte një nga dështimet. Mendoj se kryeministri Hoti duhet të reflektojë sa më parë dhe të ndërpresë këtë praktikë.

“Epoka e re”: Partneret e koalicionit qeverisës dhe partitë opozitare kane shprehur qendrimin te ndryshme per rifillimin e dialogut Kosove - Serbi. Cili është qendrimi i AKR-se per kete proces?

Matoshi: Dialogu duhet të zhvillohet pas marrëveshjes përfundimtare. Ne kemi nevojë për një marrëveshje të shpejtë me të cilën Serbia detyrohet ta njohë shtetin e Kosovës fillimisht dhe pastaj të zhvillohet një dialog që duhet të fokusohet në ekonomi dhe çështje të tjera. Rikthimi i dialogut në tema të veçanta në Bruksel nuk garanton marrëveshjen finale. Është shumë e nevojshme që të ketë përfshirje dhe rol udhëheqës të ShBA-së në dialog.

“Epoka e re”: Kjo qeveri, pervec me pandeminë dhe procesin e dialogut me Serbinë, pritet te perballlet edhe me sfiden e Gjykates Speciale. Sa besoni se një qeveri e brishte me numra ne

Kuvend mund te perballlet me keto sfida?

Matoshi: Në Kosovë po ndodhin shumë gjëra të këqija. Ne si parti nuk e imagjinojmë dhe as nuk planifikojmë asnjëherë që në tema si pandemia, dialogu e Gjykata Speciale të silllemi e veprojmë si subjekte politike veç e veç. Këto janë sfida të të gjithëve. Janë sfida të Kosovës. Kemi mjaft hapësirë e arsye të tjera për ta luajtur rolin e opozitës. Nuk e meritojnë qytetarët e Kosovës një sjellje të këllillë dhe një ndarje kaq të madhe mes grupesh të ndryshme të shoqërisë për tema nacionale e të cilat do të duhej të ishin arsye që të jemi shumë të bashkuar. AKR-ja dhe presidenti Pacolli, pavarësisht se kush do ta drejtojë qeverinë, në tema të këtylla do të jenë përherë konstruktivë.

“Epoka e re”: Ne keto rrethana po diskutohet edhe mundësia e zgjerimit te koalicionit qeverisës. A mund t'i bashkohet AKR-ja koalicionit qeverisës?

Matoshi: AKR-ja ka pasur dhe vazhdon të ketë ofertë që të jetë pjesë e qeverisë. Ka qenë vendimi ynë që të rrimë në opozitë dhe t'i mbështesim nga aty proceset. E kemi votuar qeverinë Kurti dhe atë Hoti për t'u dhënë mbështetje atyre. Jemi pro përfshirjes në qeveri nëse arrihet një marrëveshje që të kemi një qeveri gjithëpërfshirëse ose në bazë të gjerë. Këtë mundësi nuk e përjashtojmë.

Haliti: Kosovës i duhet një koalicion i madh

Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së PDK-së, ka vlerësuar se për shkak të sfidave me të cilat është duke u ballafaquar vendi, Kosovës i duhet një koalicion i madh. “Duke besuar në fuqinë e PDK-së, tek ekspertët dhe te politikanët e saj, mendoj se duhet bashkuar (sipas një marrëveshjeje) së pari me LDK-në, edhe me partitë e tjera për ta qeverisur vendin, për t'u përballur me çështjet që duhet t'i zgjedhim. Prandaj edhe po kërkoj që të lihen interesat personale për interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve”, ka shkruar Haliti



“Epoka e re”

PRISHTINË, 12 GUSHT - Anëtari i Kryesisë së PDK-së, Xhavit Haliti, ka treguar se pse është për futjen e PDK-së në koalicionin aktual qeverisës. Në llogarinë e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se për t'u përballur me sfidat e shumta, Kosovës i duhet një koalicion i madh me politikanë e ekspertë të mirë dhe të përgjegjshëm. “Mendimi i lirë i individit është pjesë e rëndësishme e demokracisë. Në PDK askush s'e penalizon askënd për mendimin e shfaqur publikisht. Si çdo kund tjetër ku kërkohet dhe më jepet rasti të flas për probleme të caktuara të sferës politike, mendimi im është i hapur edhe në organet e PDK-së. Demokracia nuk është anarki, por është diktaturë e ligjit, rregullave, statutit, e Kushtetutës. PDK-ja, pas debatit në organet e veta, të gjitha vendimet i merr me konsensus ose me shumicën e votave, të cilat çdoherë i kam respektuar dhe do t'i respektoj edhe në të ardhmen”, ka shkruar Haliti.

Sipas tij, pandemia, dialogu me Serbinë, tërheqja e njohjeve të shtetit të Kosovës dhe Gjykata Speciale janë disa prej arsyeve pse duhet të ndodhë një koalicion i tillë. “Pyetja që shtrohet shpesh këto ditë, për sa i përket koalicionit qeverisës: të hyjë PDK-ja ose

jo? Edhe në këtë rast unë e kam mendimin tim. Kosova është në udhëkryq të madh për shumë arsye. Po i numëroj disa, pa bërë kategorizim sa i përket rëndësisë së tyre: pandemia Covid-19, dialogu me Serbinë, ndalimi i njohjeve të shtetit të Kosovës, tërheqja e njohjeve të shtetit të Kosovës, Gjykata Speciale. Shto këtu edhe ekonominë e dobët, arsimimin që lë për të dëshiruar, shëndetësinë, papunësinë, korrupsionin, nepotizmin, organet e sigurisë, integritimin në institucionet ndërkombëtare, aleancat strategjike me ShBA-në, BE-në, Britaninë e Madhe etj., politika e jashtme... që të mos i numëroj të gjitha me radhë. Të gjitha këto çështje kërkojnë politikëbërje të përgjegjshme shtetërore dhe jo individë apo koalicion të brishtë si ky që e kemi”, ka shkruar Haliti, duke shtuar se për t'u përballur me të gjitha këto probleme, Kosova duhet të ketë një koalicion të madh me politikanë e ekspertë të mirë e të përgjegjshëm. “Duke besuar në fuqinë e PDK-së, tek ekspertët dhe te politikanët e saj, mendoj se duhet bashkuar (sipas një marrëveshjeje) së pari me LDK-në, edhe me partitë e tjera për ta qeverisur vendin, për t'u përballur me çështjet që duhet t'i zgjedhim. Prandaj edhe po kërkoj që të lihen interesat personale për interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve”, ka shkruar Haliti.

Tahiri i AAK-së: S'kemi probleme me LDK-në

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës nga radhët e AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme me LDK-në dhe se nuk ka pasur ashpërsim të tyre. Ai ka thënë se do t'i forcojnë këto raporte meqë koalicioni qeverisës është ndërtuar me synim që të jetë afatgjatë. Tahiri ka theksuar se si partner të koalicionit qeverisës japin mendimin e tyre për çështje të rëndësishme, siç është ajo e dialogut dhe, sipas tij, një partner i mirë e thotë mendimin me qëllim që ta ndihmojë procesin. “Raporti në mes të LDK-së dhe AAK-së, si dy parti të qendrës së djathtë, nuk është çështje. Ne nuk kemi asnjë problem. Ne e kemi shumicën parlamentare,



programet dhe qëllimet, qëndrimet që i vendosim në raport me tema nacionale si dialogu i bëjmë në formën e një partneri. E partneri i mirë është që ta thotë mendimin me shkrim dhe ballafaqon me të në mënyrë që të ndihmojë. Pra, ne nuk kemi çfarë të relaksojmë e as të ashpërsojmë. Kemi marrëdhënie pune të shkëlqyeshme të cilat besoj se do t'i kultivojmë për shkak se ky koalicion është

ndërtuar me bazën e një synimi afatgjatë. Dashtë Zoti të jetë kështu! Nëse jo, vazhdojmë tutje”, ka thënë Tahiri.

Në një konferencë për media, pas një takimi me organizata joqeveritare, Tahiri ka thënë se raportet me LDK-në nuk janë shprehur asnjëherë, duke përmendur që sot kanë zhvilluar një diskutim me kryeministrin Hoti përmes platformave online. Mospajtimet në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës kanë nisur kur shefi i ekzekutivit ka zhvilluar takim me presidentin e Serbisë në Bruksel, e në të cilin nuk e kishte marrë pranë Selim Selimin e AAK-së, ani pse si ministër i Drejtësisë ishte pjesë e delegacionit.

Nga 1 shtatori nxënësit e klasave I dhe II iu kthehen bankave shkollore

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, në Komisionin për Arsim ka thënë se klasa I dhe II do të kthehen në objektet shkollore nga 1 shtatori. Ai ka thënë se do të dezinfektohen hapësirat shkollore dhe do të zbatohet masat e tjera të institucioneve shëndetësore kundër pandemisë Covid-19. Edhe drejtori i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, në takim me kryeministrin është pajtuar që nxënësit e klasës së parë të kenë prioritet shfrytëzimin e bankave shkollore pasi, sipas tij,

ata kanë nevojë të familjarizohen edhe me mësimdhënësin. "Edhe nxënësit e klasës së dytë duhet të jenë të favorizuar në këtë drejtim pasi gjysmëvjetorin e dytë ata nuk kanë pasur mundësi t'i ndjekin mësimet në shkollë. Edhe nxënësit e klasave të gjashta do të kenë përparësi shfrytëzimin e bankave shkollore pasi kanë kaluar nga sistemi me një mësimdhënësin në atë me shumë mësimdhënësin. Edhe nxënësit e klasës së dhjetë do të kenë të njëjtën përparësi pasi kalojnë nga shkollë fillore në atë të mesme", ka thënë Ibrahim.



Në AAK kërkojnë që Haradinaj të jetë kandidat për president

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Nënkrjetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini, ka konfirmuar se brenda partisë ka pasur thirrje që kryetari i kësaj partie, Ramush Haradinaj, të jetë kandidat për president të Kosovës. Pas takimit të Këshillit Drejtues të AAK-së, Gjini ka thënë se kjo parti nuk është pro prishjes së koalicionit qeverisës me LDK-në e Nismën. Ai ka thënë se është diskutuar për çështjen e presidentit të ri, pasi



presidentit aktual Hashim Thaçi në fillim të vitit të ardhshëm i skadon mandati. "Edhe nëse nuk do të ketë konfirmim të aktakuzës ndaj presidentit Thaçi, prapëseprapë për disa muaj, 4 apo 5 do të duhet të hyjmë në proces të zgjedhjes së presidentit dhe AAK-ja nuk mendon se vendi duhet të shkojë në zgjedhje për shkak se s'do të mund ta zgjedhim presidentin. Shpresojmë që partitë të mund ta gjejnë rrugën për ta zgjedhur

presidentin e ri. Ka thirrje në Këshillin Drejtues që kryetari Haradinaj të jetë kandidat për president. Këto do t'i shqyrtojmë. Edhe me partnerë edhe parti të tjera. Ka zëra shumë të fuqishëm, mos të them shumica dërrmuese, por se a do të jetë apo jo, duhet të ketë vendim në institucionet e partisë", ka thënë ai pas takimit të Këshillit Drejtues të AAK-së. Gjini ka mohuar se partia e tij nuk e mbështet Qeverinë, pavarësisht prej kritikave për çështjen e dialogut.

Veliu: Çështja e azilkërkuesve në Kosovë po menaxhohet mirë



PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka pritur në takim njoftues shëfën e UNHCR-së në Kosovë, Erol Arduc, si dhe koordinatoren e zhvillimit të OKB-së në Kosovë, Ulrika Richardson. Në këtë takim ministri Veliu i ka njoftuar Arducin dhe Richardson për punën e MPB-së në menaxhimin e fushës së migrimit në këtë periudhë të pandemisë, duke theksuar se çështja e azilkërkuesve në Kosovë është duke u menaxhuar mirë. Po në këtë takim është diskutuar për situatën e krijuar me masat e fundit që ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe

ndihmës që mund të japin OKB-ja dhe UNHCR-ja përmes programeve të tyre në Kosovë, në funksion të menaxhimit të kësaj situatë. Bashkëbiseduesit kanë theksuar se ekziston një bashkëpunim i mirë në mes të MPB-së, OKB-së dhe UNHCR-së dhe shprehën gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit nëpërmjet projekteve të përbashkëta, me theks të veçantë në fushën e migrimit. Krahas situatës së krijuar nga pandemia dhe çështjes së emigrantëve, është biseduar edhe lidhur me çështjen e sigurisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se është e qetë dhe stabile.

Zgjatet deri më 28 gusht afati për aplikim për pagesa direkte

Prishtinë, 12 gusht (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur që afati për aplikim për pagesa direkte/subvencione për kulturat bujqësore për vitin

2020 të zgjatet deri më 28 gusht 2020. Kjo zgjatje e periudhës për aplikim është duke ndodhur për shkak të situatës së krijuar në vend nga pandemia Covid-19 si dhe kërkesave të

fermerëve, drejtorive komunale për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke ua mundësuar në këtë mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve.

Procedurat e aplikimit dhe dokumentacioni mbetet i njëjtë. Ndryshe, afati për aplikim për pagesa direkte/subvencione ishte paraparë të mbyllej më 14 gusht 2020.



Liderët institucionalë zotohen për kushte më të mira për rininë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë zotuar se do të angazhohen më shumë për përmirësimin e kushteve për rininë. Në Ditën Botërore të Rinisë ata u kanë shprehur mirënjohje të gjithë të rinjve për kontributin e jashtëzakonshëm që po e japin në ballafaqim me Covid-19. Ndërsa kryetarja e Kuvendit ka thënë se të rinjtë janë forca e vërtetë vepruese për ndryshimet e mëdha në shoqëri



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 GUSHT - Liderët institucionalë ua kanë uruar të rinjve ditën e tyre. Në Ditën Botërore të Rinisë, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë zotuar se do të angazhohen edhe më shumë për përmirësimin e kushteve për rininë në edukim dhe zhvillim profesional.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vlerësuar se rinia në Kosovë çdoherë ka qenë promotore e ndryshimeve pozitive. "Kosova është e bekuar me të rinjtë e saj të përkushtuar ndaj shtetit, punës dhe kultivimit të vlerave në funksion të zhvillimit të vendit. Në çdo periudhë historike, rinia ishte promotore e ndryshimeve pozitive. Dhe unë, ndonëse e kujtoj me nostalgji

rininë time, që nga ajo kohë angazhohem për më shumë mundësi për rininë, vend më të mirë për çdo qytetar dhe shtet më të fortë për popullin tonë", ka shkruar presidenti në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka deklaruar se Kosova është e bekuar me të rinjtë e përkushtuar ndaj shtetit dhe punës. "Edhe sot kur shënojmë Ditën Botërore të Rinisë zotohem për më shumë angazhim, që të rinjve tanë t'u krijojmë kushte më të mira dhe infrastrukturë bashkëkohore për edukim dhe zhvillim profesional", ka shkruar presidenti.

Ndërsa kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se të rinjtë janë forca e vërtetë vepruese për ndryshimet e mëdha në shoqëri. Ajo gjatë një takimi me disa të rinj ka thënë se transformimi i vërtetë i një shoqërie

nis nga edukimi i mirëfilltë i të rinjve dhe krijimi i mundësive për ushtrim të kreativitetit të tyre.

Edhe kryeministri Avdullah Hoti ka uruar të rinjtë e Kosovës me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë. Hoti ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës u është mirënjohëse të gjithë të rinjve për kontributin e jashtëzakonshëm që po japin në ballafaqimin me Covid-19. "Të dashur të rinj, urime dita juaj! Sot bëhen 21 vjet prej kur 12

gushti shënohet si Dita Ndërkombëtare e Rinisë. Qeveria e Republikës së Kosovës u është mirënjohëse të gjithë të rinjve për kontributin e jashtëzakonshëm që po e japin në ballafaqim me Covid-19. Në vend të takimeve dhe diskutimeve në aktivitetet, ne sot obligohemi të jemi të bashkuar në thirrjen tonë për kujdes të shtuar dhe respektim të masave. #vendosemasken", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, bashkë me ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi dhe përfaqësues të "Let's do it Kosova", me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, kanë shpërndarë maska në sheshet e Prishtinës. Ata kanë bërë me dije se këtë aktivitet e kanë realizuar me qëllim të sensibilizimit të të rinjve në lidhje me rreziqet e pandemisë Covid-19 dhe për ta promovuar kujdesin që duhet të kemi në përballje me këtë virus.

Osmani: Ushtria e Kosovës, shembull i profesionalizmit dhe besueshmërisë

Ministri Quni e ka njoftuar kryetaren Osmani për hapat shumë të rëndësishëm që Ministria e Mbrojtjes, e udhëhequr prej tij, i ka ndërmarrë për ngritjen profesionale të FSK-së, por edhe për thellimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit me partnerët strategjikë për përforsimin e mëtejshëm të sigurisë në vend

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka vizituar Ministrinë e Mbrojtjes, ku është prititur nga ministri Anton Quni si dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama. Në takimin me ministrin Quni dhe gjeneralletenant Ramën, Osmani ka shprehur mirënjohjen e saj dhe të Kuvendit të Kosovës për përkushtimin profesional dhe atdhetar të ushtarëve të FSK-së, për strukturën udhëheqëse të kësaj force, por edhe për angazhimin e pakursyer personal të ministrit Quni për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të FSK-së dhe për ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit.

Ajo i ka falënderuar ata edhe për angazhimin e tyre për ofrimin e ndihmës për menaxhimin e pandemisë Covid-19. "Ne e çmojmë lart përkushtimin tuaj për të punuar ngushtë me strukturat e sigurisë, përfshirë KFOR-in, për ofrimin e sigurisë së vendit, por edhe për garantimin e një ambienti të qetë, në të cilin qytetarët e vendit do të ndihen të sigurt", ka thënë Osmani.

Më tutje, ajo e ka vlerësuar evoluimin e shpejtë të FSK-së dhe i ka siguruar ministrin Quni dhe komandantin Rama se institucioni të cilin ajo e udhëheq do të punojë ngushtë me ta për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për operim të FSK-së, përfshirë hartimin e legisla-



cionit të nevojshëm. Ndërsa ministri Quni e ka njoftuar kryetaren Osmani për hapat shumë të rëndësishëm që Ministria e Mbrojtjes, e udhëhequr prej tij, i ka ndërmarrë për ngritjen profesionale të FSK-së,

por edhe për thellimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit me partnerët strategjikë për përforsimin e mëtejshëm të sigurisë në vend. Bashkë me ministrin Quni kryetarja Osmani ka vizituar shtabin e përgjithshëm të

FSK-së, në të cilin komandanti i kësaj force, gjeneralletenant Rama dhe struktura udhëheqëse e saj, e kanë informuar atë për procesin e transformimit të FSK-së dhe aktivitetet kryesore të kësaj force.

KEDS-i ndërton rrjet modern në lagjen “Qafa” të kryeqytetit

Mbi 2 000 konsumatorë në lagjen Qafa në Prishtinë, duke përfshirë edhe dhjetëra biznese, do të kenë rrjet kompatibil me rrjetet më të avancuara evropiane dhe furnizim shumë më cilësor të energjisë elektrike, ka njoftuar KEDS-i, i cili ka bërë me dije se investimet e sivjetme në kryeqytet kapin vlerën e 17 milionë eurove



në rrjet, të cilat shkaktonin në të kaluarën ndërprerje, po eliminohen tërësisht. Stabilimentet e vjetra që nuk i përshtaten teknologjisë së re energjetike, po zëvendësohen tërësisht me të reja. KEDS në lagjen ‘Qafa’ po zëvendëson edhe transformatorët, po ndërton rrjet të ri të tensionit të mesëm dhe po ngrit kapacitetet e furnizimit me energji elektrike. Kështu po krijohet linja alternative, që nënkupton se, nëse një dalje ka prishje, menjëherë furnizimi kalon në dalje alternative dhe konsumatori nuk ballafaqohet me mungesë të energjisë”, është thënë në komunikatën e KEDS-it.

Sipas kësaj komunikate, investimet e KEDS-it në Prishtinë për sivjet kapin shifrën

e 17 milionë eurove. “Në këto projekte janë të angazhuar mbi 800 punëtorë, të cilët po bëjnë maksimumin që ndalesat e energjisë elektrike të jenë sa më

të rralla në mënyrë që këto punime të kenë ndikim minimal në aktivitetet ditore të qytetarëve. Përmes këtij investimi, KEDS do të ofrojë

shërbime moderne dhe të kualitetit më të lartë për konsumatorët e kryeqytetit”, është thënë në fund të komunikatës.

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

Prishtinë, 12 gusht - Kompania e Kosovës për Distribuim të Energjisë Elektrike Sh.A Kosovo (KEDS) është duke investuar fuqishëm edhe në lagjen “Qafa” të Prishtinës. Mbi 2 000 konsumatorë të kësaj lagje, duke përfshirë edhe dhjetëra biznese, do të kenë rrjet kompatibil me rrjetet më të avancuara evropiane dhe furnizim shumë më cilësor të energjisë elektrike, është thënë në komunikatën e dërguar për media nga KEDS-i. “Rrjeti i instaluar aty dekada më parë pothuajse ka përfunduar jetëgjatësinë e tij. Me rritjen e numrit të banorëve në këtë lagje është rritur edhe kërkesa për energji elektrike. Mbingarkesat

në rrjet, të cilat shkaktonin në të kaluarën ndërprerje, po eliminohen tërësisht. Stabilimentet e vjetra që nuk i përshtaten teknologjisë së re energjetike, po zëvendësohen tërësisht me të reja. KEDS në lagjen ‘Qafa’ po zëvendëson edhe transformatorët, po ndërton rrjet të ri të tensionit të mesëm dhe po ngrit kapacitetet e furnizimit me energji elektrike. Kështu po krijohet linja alternative, që nënkupton se, nëse një dalje ka prishje, menjëherë furnizimi kalon në dalje alternative dhe konsumatori nuk ballafaqohet me mungesë të energjisë”, është thënë në komunikatën e KEDS-it.

Sipas kësaj komunikate, investimet e KEDS-it në Prishtinë për sivjet kapin shifrën

OEAK-u kërkon nga qeveria të bashkëpunojë me sektorin e gastronomisë para marrjes së vendimeve

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës duhet të jetë në konsultim të ngushtë me komunitetin e biznesit para marrjes së çfarëdo mase që ka ndikim në këto biznese, është thënë në takimin e rregullt të Komitetit të Gastronomisë dhe Turizmit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK).

Anëtarët e këtij komiteti kanë vlerësuar se është e domosdoshme të shpejtohet votimi dhe fillimi i aplikimit të pakos së rimëkëmbjes ekonomike të propozuar nga qeveria sepse shumë biznese në këtë sektor rrezikojnë të mbyllën, duke rezultuar



kështu në humbje të mëdha të vendeve të punës. Sipas tyre, një çështje tjetër me rëndësi për t'u trajtuar është edhe ajo mbi pasigurinë e mbarëvajtjes së punës siç është caktuar deri më tani në ambiente të hapura pas muajit shtator, kur kushtet klimatike do të pamundësojnë një gjë të tillë. “Komiteti i Odës Amerikane për Gastronomi dhe Turizëm thekson se është më se e nevojshme të zbatohen vendimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë dhe të rriten kapacitetet inspektuese, e jo të aplikohen kufizime kolektive për të

gjitha ndërmarrjet për shkak të moszbatimit të masave nga një numër ndërmarrjesh. Për më tepër, anëtarët e këtij komiteti bëjnë thirrje edhe për heqje të masës për kufizim të lëvizjes pas orës 22:30, e cila, sipas tyre, nuk është se ka dëshmuar të jetë efektive”, ka njoftuar OEAK-u. Sipas këtij njoftimi, ky komitet ka për qëllim adresimin e nevojave të sektorit të gastronomisë dhe turizmit si në periudhën afatshkurtër, pra për fazën e rimëkëmbjes ekonomike pas shpërthimit të pandemisë Covid-19, ashtu edhe në atë afatgjatë.

Nesër shqyrtohet Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka mbajtur të mërkurën një mbledhje në mënyrë elektronike (virtuale), nën drejtimin e kryetares Vjosa Osmani. Në këtë mbledhje kryesia ka shqyrtuar propozimin e deputetit të LDK-së, Haxhi Avdyli, mbështetur edhe nga

41 deputetë të tjerë nënkrahues, për formimin e komisionit hetimor parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për leje të hidrocentraleve në Republikën e Kosovës. Pas diskutimeve, kryesia ka vendosur që formimi i këtij komisioni të jetë pikë e rendit të ditës në seancën e së

nesërme (e premte), më 14 gusht 2020. Sipas vendimit të seancës së datës 7 gusht, pikë e parë e rendit të ditës së seancës të së premtes do të jetë shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, seanca do ta shqyrtojë për herë të parë Projektligjin

nr. 07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike Covid-19. Në vazhdim të mbledhjes, kryesia është njoftuar me ecurinë e punimeve të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, të zhvillu-



ar gjatë muajit qershor të këtij viti dhe për herë të parë të kryesuar nga Kosova.

Miratohet lista e dëshmitarëve për procesin e privatizimit

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, i cili është iniciuar nga PDK-ja, ka miratuar listën e dëshmitarëve të cilët pritet të dëshmojnë në këtë proces. Në mbledhjen e këtij komisioni është bërë me dije se kjo listë nuk është përfundimtare dhe se mund të zgjerohet gjatë zhvillimit të procesit hetimor parlamentar

“Epoka e re”

PRISHTINË, 12 GUSHT - Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë ka miratuar listën e dëshmitarëve. Kjo listë përfshinë gamë të gjerë zyrtarësh me ish-funksione publike dhe private që ndërlidhen me privatizimin. Ani pse nuk është bërë publike lista me emra për secilin që do të dëshmojë, ish-ministra, ish-kryesues bordesh, udhëheqës të AKP-së, po ashtu ish-përfaqësues të huaj në Kosovë do të dëshmojnë para këtij komisioni.

Gjatë mbledhjes së këtij komisioni, e cila është mbajtur të mërkurën, janë shfaqur dilema për largimin e disa emrave si ish-zëvendëskryesuesi i bordit i AKP-së, njëherësh anëtar i

LDK-së, Naser Osmani dhe ish-përfaqësuesi i UNMIK-ut, Adrea Capusela. Për të parin është thënë se për të njëjtën çështje ka një proces gjyqësor dhe mund të ketë ndërhyrje në drejtësi, e për përfshirjen e tij ose jo është kërkuar një interpretim ligjor nga Zyra Ligjore e Kuvendit të Kosovës. Ndërsa nga PDK-ja është kërkuar që ish-zyrtari i UNMIK-ut, Adrea Capusela, të largohet nga lista e dëshmitarëve për shkak, siç është thënë, afërsisë me subjekte politike në Kosovë.

Kryetari i komisionit, Hajrullah Çeku, ka thënë se lista është bazuar në strukturën dhe kategoritë e dëshmitarëve për punën e komisionit, për të cilën ka bërë me dije se mund të ndryshojë. “Jam bazuar në atë strukturën që e kemi miratuar brenda planit të punës ku



janë caktuar kriteret dhe kategoritë e dëshmitarëve që duhet t'i ftojme për punën e komisionit. Kjo nuk do të thotë se do t'i ftojme të gjithë këta. Nuk nënkupton se kjo është listë përfundimtare. Në momentin që e miratojmë një listë këtu të fusim edhe një klauzolë në fund që kjo listë është dinamike. Gjatë procesit të punës, nëse paraqitet nevoja, do ta pasurojmë këtë listë me emra të rinj”, ka thënë Çeku. Ndërsa anëtarja e këtij komisioni nga LDK-ja, Doruntinë Maloku, ka kërkuar përfshirjen

edhe të ish-ministrit të Tregtisë, Bujar Dugolli dhe largimin e bashkëpartiakut të saj, Naser Osmani që, sipas saj, për çështje të privatizimit është një proces gjyqësor karshi tij. “Ju keni paraqitur disa emra të ish-ministrave që sipas funksionit kanë qenë pjesë e bordit të AKM-së së atëhershme, por mungon emri i ish-ministrit Bujar Dugolli. Te lista e anëtarëve dhe kryesuesve të bordit e kemi çështjen te zëvendëskryesuesi Naser Osmani i cili momentalisht është pjesë e një hetimi dhe

procesi gjyqësor në lidhje me procesin e privatizimit. Prandaj në emër të LDK-së kërkoj që ta largojmë emrin e Naser Osamnit për shkak se ndodhet në një proces tjetër dhe ne nuk kemi të drejtë të interferojmë, apo të bëjmë një hetim paralel për çështje të privatizimit. Në vend të tij propozoj që të jetë ish-anëtar i bordit, përfaqësuesi i sindikatave të punëtorëve, zotëri Haxhi Arifi. Te lista e përfaqësuesve ndërkombëtarë në Kosovë, propozoj të jetë edhe Marie Fuci”, ka propozuar Maloku.

Hoti kërkon siguri dhe transparencë gjatë tërheqjes së mjeteve nga Trusti

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar nga drejtuesit e Trustit që aspektet teknike dhe procedurat e tërheqjes së mjeteve të jenë të sigurt dhe transparente për qytetarët, të cilët dëshirojnë t'i tërheqin mjetet e tyre. Ndërsa ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se është angazhuar që procesi i tërheqjes së këtyre mjeteve të jetë i thjeshtë dhe pagesat të kryhen sa më shpejt, pas kalimit të Ligjit për rimëkëmbjen ekonomike në Kuvendin e Kosovës



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, kanë zhvilluar të mërkurën një takim virtual me drejtuesit e Trustit, me të cilët kanë biseduar rreth ecurisë së përgatitjeve për realizimin e tërheqjes së 10-përqindëshit nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sipas njoftimit të qeverisë, kryeministri Hoti ka kërkuar nga drejtuesit e Trustit që

aspektet teknike dhe procedurat e tërheqjes së mjeteve të jenë të sigurt dhe transparente për qytetarët, të cilët dëshirojnë t'i tërheqin mjetet e tyre.

Ndërsa ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, është angazhuar që procesi i tërheqjes së këtyre mjeteve të kryhen sa më shpejt, pas kalimit të Ligjit për rimëkëmbjen ekonomike në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, kryeministri Hoti dhe ministrja Bajrami kanë zhvilluar një takim edhe me drejtuesit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, nga të

cilët është kërkuar që ky institucion t'i mbështesë bizneset me rreth 40 milionë euro pas miratimit të Ligjit për rimëkëmbjen ekonomike. Kryeministri Hoti ka thënë se është koha të mbështeten të gjitha bizneset, sidomos ato të sektorit të bujqësisë dhe bizneseve prodhuese të orientuara në eksport. Qeveria e Kosovës do t'i

mbulojë shpenzimet e administrimit të këtyre fondeve. “Po ashtu, qeveria do të bashkëpunojë me Bankën Qendrore të Kosovës, me bankat komerciale, me asociacionet e biznesit, odat e ekonomike etj., me qëllim që ky proces të sigurojë gjithëpërfshirje, transparencë dhe qasje më të lehtë dhe me kosto më të ulët të bizneseve në

këto kredi. Këto nisma dhe instrumente financiare të propozuara dhe të mbështetura nga Qeveria e Kosovës janë ndërmarrë me qëllim që qytetarëve dhe bizneseve t'u krijohet mundësia e qasjes në burimet financiare për tejkalimin e gjendjes ekonomike të krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Nënshkruhet memorandumi për fuqizimin ekonomik dhe social të grave

FERIZAJ, 12 GUSHT - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me kryesuesen e Kuvendit Komunal, Kristina Gashi-Bytyçi, kanë pritur në takim drejtuesit e organizatës "Woman 4 Woman", qëllimi i të cilit ishte nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për fuqizimin ekonomik e social si dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse të grave. Ky memorandum parasheh koordinimin institucional të veprimeve në mes të Komunës së Ferizajt dhe organizatës së lartcekur me qëllim që pozita e gruas në sferën ekonomike, sociale e

vendimmarrëse të avancohet.

Drejtuesit e organizatës "Woman 4 Woman" kanë thënë se Komuna e Ferizajt qëndron në një shkallë të konsiderueshme zhvillimi dhe përparimi në këtë fushë, ndonëse lypsen ende veprime për fuqizimin e mëtejme të kësaj fushe. Ndërsa kryetari Aliu ka thënë se qeverisja e tij ka vullnetin e plotë e gjithë energjinë që këtë kauzë ta sensibilizojë edhe më tutje përmes veprimeve konkrete, ndonëse Ferizaj paraqet një model për mundësinë dhe fuqizimin e grave në pozita të rëndësishme vendimmarrëse.



Jashari nënshkroi kontratat për bursa me 170 studentë përfitues

SKENDERAJ, 12 GUSHT (ER) - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka nënshkruar kontratat për bursa me 170 studentë, në shumën prej 300 eurosh, për studentët e universiteteve publike në Kosovë. Pasi ka uruar të rinjtë për ditën e rinisë dhe përfitimin e bursës nga komuna, Jashari ka vlerësuar lart kontributin historik të rinisë duke deklaruar se vullneti, vizioni dhe guximi i rinisë për mbrojtjen e vendit, historisë, kulturës e arsimit është shembull që duhet ndjekur edhe sot nga ju të rinj dhe gjeneratat që vijnë. "Jam i vetëdijshëm me pozitën tuaj në



shoqëri, me sfidat që keni në rrugën tuaj të ngritjes profesionale, vështirësitë për t'u punësuar, por në asnjë mënyrë nuk duhet të

zhgënjeheni, sepse jeni ju ata që duhet të bëni ndryshimin, ju jeni vetë ndryshimi që duhet sjell në vendin tonë. Ndryshimi arrihet me punë, me aktivizim

rinor e qytetar, me përgatitje profesionale, bashkim të ideve e kapaciteteve që keni në mënyrë që ta jetësojmë amanetin e atyre që dhanë jetën

për të pasur një shtet të zhvilluar, në shërbim të qytetarëve dhe mirëqenies së tyre", deklaroi kryetari Jashari, duke shtuar se beson në potencialin që ka rinia jonë. "Njëjtë do t'i keni hapur dyert edhe ju, sepse unë besoj në rini dhe kapacitetet e tyre për t'i zgjidhur problemet dhe sfidat që kemi para nesh, prandaj përkrahja ime dhe e komunës që unë udhëheq nuk do të mungojë asnjëherë", ka thënë Jashari.

Ndërsa në emër të studentëve në këtë ceremoni ka folur studentja Shqipdona Ademi, e cila ka falënderuar kryetarin Jashari për përkrahjen dhe angazhimin e tij për të rinjtë e Komunës së Skenderajt.

Haziri: Nuk mund të ndërtojmë arsim online në Kosovë

GJILAN, 12 GUSHT (ER) - Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë të mërkurën se po shqyrtohen seriozisht tri opsionet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për vitin e ri shkollor, por ka shtuar se nuk është në përgjegjësinë e tyre se cili nga këto opsione do të duhej të implementohet për normalizim të sistemit të arsimit. Ai ka thënë se nuk mund të ndërtojmë arsim online në Kosovë pasi, sipas tij, nuk kanë as përvojë e as kapacitete teknologjike. "Unë mbetem i përkushtuar që arsimi duhet të normalizohet me vijueshmëri të rregullt në shkollë, por duhet të gjendet modaliteti që të parandalohet përhapja e infeksionit. Është e paqëndrueshme të pretendohet që mund të ndërtojmë arsim



online në republikën tonë, pa kurrfarë kapacitete, përvoje e mundësie teknologjike. Edhe ashtu sistemi arsimor në Kosovë në rrafshin e vlerësimit të PISA-s është shumë keq dhe pandemia mund ta përkeqësojë", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se

arsimtarët, prindërit, nxënësit dhe institucionet komunale duhet të mobilizohen në gjetjen e rrugës më të mirë, në mënyrë që testi i pjekurisë, regjistrimi i nxënësve dhe fillimi i shkollës të normalizohet në kushte pandemie.

Rruga 'Rexhep Krasniqi' shtrohet në asfalt

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Pas tre muajve të rregullimit, të shtrim-it me zhavorr dhe rërë, më në fund dje është asfaltuar rruga "Rexhep Krasniqi" në lagjen Kalabria në Prishtinë. Punimet e kësaj rruge janë shtyrë gjatë, në radhë të parë për shkak të pandemisë Covid-19. Por, me rastin e fillimit të punimeve, shumë banorë të kësaj lagje e të kësaj

rruge shpeshherë kanë shprehur pakënaqësi edhe në media për kontraktin dhe komunën si investitore për shkak të vonesës së rregullimit të rrugës dhe për shkak se shumë puseta të kanalizimit operatori ekonomik i kishte lënë hapur dhe pa shenja sinjalizuese saqë kishte ndodhur që në të binte edhe veturë.



KËRKESË PUBLIKE KRYETARËVE TË PARTIVE POLITIKE TË KOSOVËS



Jakup KRASNIQI

Kryetarë të nderuar,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për gjendjen e rëndë që ka përfshirë të gjitha segmentet e funksionimit politik dhe shoqëror të Kosovës dhe mungesën e zgjidhjeve konstruktive për të dalë nga kjo

situatë me pak shpresa për zgjidhjeje.

Pandemia me virusin Covid-19 na gjeti paraprakisht të infektuar me virusin e përçarjes së madhe ndërpartiake, i cili na ka verbuar deri në atë shkallë sa që nuk mund të gjenim as minimumin e konsensusit për t'i bërë ballë rrezikut që i kanoset njerëzimit në përgjithësi. Fatkeqësisht, edhe si pasojë e kësaj gjendjeje, ku njëri i bie thumbit e tjetri patkoi, çdo ditë më shumë jemi duke i ndier pasojat në humbjen e jetëve të njerëzve tanë.

Është e kuptueshme se në rastet kur ekzistenca e njerëzve "vihet në rend të ditës", njerëzit kanë orientuar shpresat gjetjen e një zgjidhjeje në nivel global dhe, rrjedhimisht, shpresat i kanë mbështetur në ndihmën nga jashtë dhe gjetjen e një vaksine kundër këtij virusi. Besoj se nuk do të vonojë shumë dhe shkenca do ta gjejë "ilaçin" edhe për këtë të keqe që na ka gjetur. Mirëpo, "ilaçin" që do të na shëronte nga përçarja apo, së paku ta mbante në kufijtë e asaj që është e tolerueshme, duhet ta gjejmë ne vetë dhe jo të presim

ndihma nga jashtë! Zgjedhjet e problemeve të brendshme janë vetëm brenda nesh! Njëzet vitet e lirisë e dymbëdhjetë vitet e pavarësisë e konfirmojnë këtë.

Gjendja dramatike e shëndetësisë, e arsimit, e ekonomisë, e drejtësisë dhe e kulturës së debatit shtrojnë si domosdoshmëri përpara udhëheqësve të partive politike që t'i ulin urrejtjet ndërpersonale dhe t'i lënë mënjane egot e tyre, por t'u përvishen punëve që u takojnë t'i bëjnë në interes të qytetarëve të këtij vendi.

Mendoj se është koha që të ulen në një tryezë ku nuk do të shkojnë për t'i hëngër kokën njëri-tjetrit, por për t'i shtruar problemet jetike me të cilat ballafaqohet populli ynë në përgjithësi. Në të kundërtën, pasojat e tekeve individuale do t'i paguajmë të gjithë. Bile me çmim shumë më të lartë sesa e kishim edhe deri tani!

Me mirëkuptim e mirëbesim mund t'i zgjidhim më lehtë e më shpejt problemet tona të brendshme, por edhe ato të jashtme! Të shpresojmë në zgjedhjet e drejta e të qëndrueshme!

LIGJI PËR MBROJTJEN E VLERAVE TË LUFTËS DHE ARGATËT ANTI-UÇK, ANTI-KOSOVË DHE ANTI-SHBA



Shkruan: Hisen BERISHA

Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së e lexova me kujdes. Ligji nuk ka një përmbajtje solide dhe strukturë, nuk definon konceptet dhe ka dispozita që janë gjithëpërfshirëse. Do një dorë ekspertize juridike. Shqetësues dhe determinues e shoh reagimin e ambasadorit të ShBA-së, Sh. T. Z. Kosnett, të cilin, nëse e shohim në prizmin e kulturës dhe formimit të tij mbi vlerat nacionale të shtetit e kombit amerikan që i njëjti përfaqëson në Kosovë si: nderi, detyra, lojaliteti, integriteti, guximi profesional, guximi personal apo kuraja qytetare për të thënë të vërtetën, edhe ka sens, meqë supozohet se në edukimin familjar, arsimor e shoqëror, tiparet e karakterit, morale e psikologjike që e krijojnë nderin e çdo qytetari, duhet të qëndrojnë vlerat sublime kombëtare siç është, së pari, kodi gjenetik familjar e deri siç në rastin tonë, lufta për liri dhe vlerat e saj. Zaten për këtë presidenti Bush nxori Ligjin "Patrioti" dhe Ligjin e lirisë, për t'i mbrojtur veteranët nga gjuetia politike e pushtetit të demokratëve. Por, po ashtu, edhe sponsorizuesit e Ligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës kanë plotësisht të drejtë për këtë nismë ligjore. Ngase jo vetëm si shtet apo komb në formim, por as si komb shqiptar në përgjithësi nuk

kemi sistem të vlerave dhe as kodifikim ligjor të tyre. Prandaj, meqë jemi në fazën kritike të vënies së themeleve të identitetit tonë shtetëror e kombëtar, na duhet të mbrojmë me ligj qoftë edhe të atakueshëm nga mendësia e ambasadorit amerikan, parë nga prizmi i lirisë dhe të drejtës për të menduar, vlerësuar, gjykuar e shprehur lirshëm apo edituar, ngaqë në themelet e shtetit dhe identitetit tonë historikisht e kemi si vlerën më sublime dhe më të realizuar UÇK-në dhe luftën për çlirim të Kosovës. Por, duhet pasur parasysh se është krijuar keqkuptim në interpretim gjatë komunikimit apo prezantimit, ashtu siç mund të lexohet në reagimin e ambasadorit z. Kosnett, shqetësimi i tij se Gjykata Speciale me këtë ligj do të mbetet pa dëshmitarë, çka përbën një keqkuptim në interpretim. Pastaj liria e shprehjes në Kosovë nuk iu ndalua as Shkëlzen Gashit, as atij grindavecit që bën vija të kuqe nëpër sheshe e që konstaton se serbët në Kosovë sot po jetuakan nën të njëjtin terror shtetëror siç shqiptarët nën regjimin e Millosheviqit, as grupit të satiristëve "Stupcave" që kanë incizuar skeçe akuzuese, fyese e denigruese kundër UÇK-së. Ka edhe grupe muzikore që kanë incizuar këngë po aq denigruese edhe prapë askush nuk i ka terrorizuar për fjalën e lirë dhe veprat editoriale. Prandaj kam frikën se z. Kosnett po merr në mbrojtje një strukturë të mirë të organizuar anti-UÇK, anti-Kosovë, bile edhe më shumë se kaq, anti-Amerikë. Kështu që mbetet që sponsorizuesit e ligjit të qartësohen me

ambasadorët, asquis komunitare të BE-së etj., dhe ligjin pas një rishikimi të përmbajtjes konceptuale ndërlidhur me qëllimin, ta miratojnë. Se çka dhe kë e pengon ky ligj, më së miri e ka shpërfaqur kuptueshëm Milovan Dreçuni nga njëfarë komiteti serb për Kosovën. Ku deklaroi se ky ligj i tremb dëshmitarët që të dëshmojnë se në Reçak s'ka pasur masakër as kudo tjetër gjatë luftës në Kosovë. Shqiptarët kanë krijuar një imazh tjetër këto vite dhe ata e kanë transferuar përgjegjësinë për krimet e tyre te forcat serbe. Në anën tjetër, mua më duket se ligji ka një funksion tjetër më të rëndësishëm sesa ai që thuhet, t'i parandalojë njerëzit që të flasin për krimet e UÇK-së dhe të mos thonë që në Reçak nuk kishte masakër, sikur për shumë vende ku u ekzekutuan

shqiptarët dhe serbët. Lidhur me pretendimin e ruajtjes/mbrojtjes së këtyre vlerave në muze dua të theksoj se lufta si vlerë dhe vlerat e lirisë, nuk mbrohen në muze, as në Amerikë dhe në asnjë vend tjetër të botës.

Atëherë pas këtyre që po them shtrohen dy pyetje për shkëlqesinë e tij z. ambasador: 1. Ambasador, a janë shkelje e të drejtave të njeriut aktakuzat e përsëritura dhe që rezultuan shpifjet, ta zëmë, ndaj z. Ramush Haradinajt, edhe pas dy vendimeve të gjykatës ndërkombëtare në Hagë? A gëzon ky person liri individuale? 2. Ambasador, veteranët e luftës së UÇK-së, të shpallur si të tillë nga një ligj me bazë kushtetuese, i miratuar dhe i pranuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, a duhet të mbrohen institucionalisht nga gjuetia e

politikës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, derisa Policia e Kosovës të bëhet pjesë e Interpolitit që të mos arrestohen mbi bazën e padive të Serbisë dhe dëshmitarëve të stisura të dëshmitarëve të stimuluar? A janë këta veteranë të UÇK-së, grupi që duhet t'i gëzojë të drejtat e liritë si dhe privilegjet individuale në kuadër të të drejtave dhe lirive të njeriut të cilave ju iu referoheni? Ky ligj ka një qëllim dhe mision, vlerësoj unë, që do t'i kodifikojë e mbrojë pikërisht vlerat e luftës për liri të UÇK-së, që qëndrojnë në themelet e shtetit e të identitetit tonë kombëtar. Mungesa e tij për gjithë këto vite ka bërë që sot të kemi në vazhdimësi cenim të vlerave të lirisë, që po pengojnë funksionalitetin e shtetit të Republikës së Kosovës dhe bërjen e saj ambient të sigurt për të gjithë.



ShBA-ja blen edhe 100 milionë doza të vaksinës kundër Covid-19

WASHINGTON, 12 GUSHT - Shtetet e Bashkuara kanë arritur marrëveshje në vlerë të 1.5 miliard dollarëve me kompaninë "Moderna" për furnizim me 100 milionë doza të vaksinës eksperimentale kundër koronavirusit. Për këtë marrëveshje ka njoftuar Shtëpia e Bardhë më 11 gusht. ShBA-ja ka arritur marrëveshje edhe me kompani të tjera për të siguruar miliona doza të vaksinës kundër sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi. Ekipi i administratës së

presidentit amerikan, Donald Trump, për këtë çështje është duke bërë përpjekje për zhvillim, prodhim dhe shpërndarje të vaksinës kundër koronavirusit deri në fund të vitit. "Moderna", në bashkëpunim me Institutet Kombëtare për Shëndetësi në ShBA, janë duke kryer fazën e tretë të testimeve klinike dhe janë duke prodhuar disa doza që, në rast të rezulttit të suksesshëm, shpërndarja e saj të jetë më e lehtë. Në gjithë botën janë duke u zhvilluar më



shumë se 150 vakcina kundër këtij virusi, kurse 25 janë testuar edhe në njerëz, ka thënë Organizata Botërore e

Shëndetësisë.

Më 11 gusht Rusia është bërë shteti i parë që ka thënë të ketë miratuar vaksinën kundër Covid-19, duke e emëruar "SputnikV". Mirëpo deklarata e presidentit rus Vladimir Putin, se vakcina është e sigurt dhe efektive, janë parë me dyshim nga shkencëtarët. Ata kanë vënë në pikëpyetje vendimin për regjistrim të vaksinës para përfundimit të fazës së tretë të testimit dhe rishikimit të rezultateve nga ekspertë të pavarur mjekësorë.

Turqia dëshiron zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Greqinë përmes dialogut

ANKARA, 12 GUSHT - Turqia dëshiron zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Greqinë përmes dialogut, ka thënë ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Hulusi Akar. Tensionet mes dy anëtarëve të NATO-s janë rritur qëkur Ankaraja filloi operacionet e kërkimit të naftës dhe gazit në një zonë të diskutueshme të Detit Mesdhe të hënën. Greqia ka theksuar se anija eksploruese e Turqisë, "Oruc Reis", është duke operuar në mënyrë të paligjshme në ujërat që bien në sferën kontinentale të Greqisë, akuzat të cilat Ankaraja i ka hedhur poshtë. Anija turke shoqërohej nga disa anije luftarake. Edhe



Greqia ka dërguar luftanijet e saj në rajon. "Ne duam të arrijmë zgjidhje politike përmes mjeteve paqësore në përputhje me ligjet ndërkombëtare", ka thënë Akari

për agjencisë "Reuters". Akari ka thënë se Turqia do të vazhdojë t'i mbrojë "të drejtat dhe interesat" e saj në ujërat bregdetare. Ndërsa ministri i Jashtëm i

Greqisë, Nikos Dendias, do të takohet të premten në Vjenë me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, për ta diskutuar situatën e fundit. Të premten pritet të mbahet edhe një mbledhje urgjente online midis ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian të cilët do të diskutojnë për tensionet në rritje mes të Greqisë dhe Turqisë. Ankaraja është zemëruar nga një marrëveshje që Greqia nënshkroi me Egjiptin të enjten e kaluar, e cila përcakton kufijtë e tyre detarë dhe zonat ekskluzive ekonomike për të drejtat e shfrytëzimit të burimeve. Vitin e kaluar Turqia ka nënshkruar


një marrëveshje të ngjashme me qeverinë libiane të mbështetur nga Kombet e Bashkuara në Tripoli. Marrëveshja Turqi-Libi ka shkaktuar zemërim në Greqi, Egjipt dhe Qipro, duke thënë se ajo cenonte të drejtat e tyre ekonomike në Mesdhe. Greqia dhe Turqia kanë pasur tradicionalisht marrëdhënie të tendosura dhe kanë qenë në mosmarrëveshje për dekada të tëra për një sërë çështjesh. Të dyja vendet kanë qenë në prag të luftës tri herë, që nga mesi i viteve 1970, duke përfshirë edhe një herë mbi të drejtat e eksplorimit të pasurive nënujore.

Joe Bideni zgjedh një afrikano-amerikane kandidate për nënpresidente

WASHINGTON, 12 GUSHT - Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), kandidati demokrat për president, Joe Biden, ka zgjedhur senatoren Kamala Harris kandidate për nënpresidente për zgjedhjet e 3 nëntorit 2020. Është e para herë që një afrikano-amerikane zgjedhet si kandidate për nënpresidente nga njëra nga partitë

kryesore. Bideni e ka bërë publike zgjedhjen e tij në faqen e tij të fushatës, që tashmë ka në faqen e parë emrat e Bidenit dhe Harrisit dhe një fotografi të tyre, së bashku. Ai e ka njoftuar zgjedhjen e tij edhe në "Twitter": "Kam nderin e madh të njoftoj se kam zgjedhur Kamala Harrisin, një luftëtare e guximshme për të

pafuqishmit dhe një nga zyrtarët më të mirë publikë, si kandidate për nënpresidente". Nuk ka vonuar shumë reagimi i presidentit Donald Trump në lidhje me veprimin e Bidenit. Ai ka thënë se Joe Bideni "po ia jep frenat në dorë Kamalës, ndërsa të dy ata përqafojnë të majtën radikale", është thënë në videon e shpërndarë nga Trumpi.




Britania e Madhe përballet me recesion pas 11 vjetëve

LONDËR, 12 GUSHT - Britania e Madhe edhe zyrtarisht po përballet me recesion për herë të parë në 11 vjet për shkak të pandemisë me koronavirus. Ekonomia e këtij shteti është tkurrur në një rekord prej 20-përqindësh në periudhën prill-qershor, kur masat e izolimit për

shkak të koronavirusit kanë qenë më të ashprat. Një ekonomi konsiderohet se është në recesion nëse tkurret për dy çerekë të njëpasnjëshëm. Të dhënat zyrtare tregojnë se kjo është tkurrja më e madhe që është raportuar nga ndonjë ekonomi tjetër e madhe. Ekonomia e

Britanisë së Madhe konsiderohet e gjashta për nga madhësia në botë. Zyra Kombëtare e Statistikave ka thënë se ka pasur shenja për rimëkëmbje në muajin qershor, kur rritja e bruto-prodhimit të brendshëm është rritur për 8.7 për qind në krahasim me muajin maj.

Letrat që Ndre Mjeda ia dërgoi Gustav Mayer-it



Nga: Martin CAMAJ

Në faqet e kësaj reviste (Shejzat – v.j.), vjeti X – 5-6 (1966) 180-189 – patëm pru dymbëdhjetë letra të Ndre Mjedjes, dërgue nga Polonia albanologut Gustav Meyer në Graz. Aty Poeti ynë na del në një dritë të re, sepse na paraqitet për të parën herë si letërshkrues me një stil elegant në gjuhën italishte, ku flet për vete, për gjuhën shqipe e vendin e vet me një dashuni të flakët të një Rilindasi së vërtetë. Ky stil i natyrshëm na zbulon Mjedjen në një prizëm real të karakterit të tij të pjekun dhe të matun.

Adhurimi që ka për Meyer-in si mjeshtër nuk e pengon që me një ton nderues t'i shprehë anët e dobta dhe lajthimet, në të cilat kishte ra albanologu i përmendun. Qëllimi i Mjedjes është që Meyer-i të mbështetet në gjurmimet e veta në landë të sigurtë të shqipes, prandaj e dënon fjalorin e Rossi-t, që Meyer-i kishte shfrytëzue. Mjerisht nuk i kemi letrat e Meyer-it: kushdi ku kanë mbarue gjatë udhëtimeve të shumta të Mjedjes jashtë dhe mbrenda Shqipnisë.

Shihet qartë se dhe Meyer-i diktoi në Poetin tanë një mendë të mprehtë dhe njeri me një intuicion të sigurtë. I përgjegji menjherë; i dërgon për këndim, librat e bibliotekës së vet private, gjë që nuk ndodh lehtas ndër dijetarë.

Letra e fundit e Mjedjes nga

Krakovia mban datën e 16 marcit 1893. Pata mendue (shif Shejzat 5-6, 1966, fq. 181, 189) se ky letërshkëmbim muer fund me këtë rasë. Tue pasë përduersh tashiti të gjitha letrat, dërgue Gustav Meyer-it nga gjuhëtarët e kohës, sidomos shumë me randësi ato të albanologut Holger Pedersen dhe të Rilindasve shqiptarë, si të K. Kristoforidhit, të Mitkos, etj., që do të dalin veçmas për shpejti si landë historie shkencore pranë "Südost Institut" të München-it, gjej tash edhe tri letra tjera të Mjedjes, një nisë nga Görz dhe dy: nga Portorë afër Fiume-s.

Në letrën e parë Poeti i lyp të falun dijetarit për heshtjen e gjatë dyvjeçare. Poeti nuk tregon se për ç'arësye nuk ka shkruar tash dy vjet. Ngjan se gjatë kësaj kohe Mjedja nuk ka pasë kohë të mirret me çashtjen e shqipes. Natyrisht ai nuk përmend gjë nëse ka pasë vështirsi në rrugën e jetës që kishte marrë. I kënaqun asht Poeti se i dërgon Meyer-it si dhunti kopjen e parë të fjalorit të Jungg-ut, dërgue nga Shkodra në fashikuj e që ende nuk gjindej në shitje. E siguron se asht i saktë në dhanjen e trajtës së vërtetë të fjalëve shqipe si dhe kuptimit e se nuk mund të krahasohej me fjalorin e Rossi-t, që Poeti e mban të pasigurtë. Ankohet se "ata zotnitë" atje në Shkodër mbështeteshin gjithnji në tradicion e se nuk doshin të pranoshin disa shenja të grafisë së Meyer-it. Mjedja, si dihet dhe

nga aktet e Kongresit të Monastirit, asht kundra përdorimit të dy shkrojave për një tingull: ai ndjek parimin, që sot kanë disa gjuhëtarë modernë, se çdo shenj grafik duhet të përfaqsojë një tingull ase si thohet sot një fonem. Asht kundra prandaj që s'është shkruhet me dy germa sh si dhe zh në vend të ž etj.

Poeti nuk din se çka ka dalë mbi gjuhën shqipe ndër rrethet e gjuhëtarëve të huej qysh prej korrikut të 1893. Lajmron se posë librave dërgue dy vjet përpara as në Romë dhe në Shkodër nuk ka dalë ndonji gjë e re. A mund ta ketë këputë letërshkëmbimin me Meyer-in sepse nuk ka pasë t'i komunikojë ndoj gjë të re?

Në letrën e dytë Mjedja lajmon se ka ndrrue prap vend: prej Görz (Gorizia) asht transferue në Portorë, në kështjellin e Frangipane ku jezuitët kishin një shkollë dhe një kuvend. Në këtë kolegji Mjedja asht profesor i filozofisë. Ngjan se asht i kënaqun dhe i impresionuem prej bukurisë së këtij vendi. Bora që Poeti e quen Buro, sigurisht si alusion i etimologjisë së Meyer-it (EW. fq. 55), shkruen se asht i tëmerrshëm, kur ai fryn. Ka shpresë se vjetin e ardhshëm do të botojë diçka në gjuhën shqipe "natyrisht, thotë, tash për tash gjithnji sende të divotshme". Sigurisht Mjedja në këtë kohë rreket të shkruente poezi mbi historinë e lashtë të Shqipnisë dhe popullin ilir, në trajtën e

Lissus. Lajmron se në Shkodër ipeshkvijt shqiptarë doshin të themeloshin një akademi studimesh shqiptare e se propozimi kishte ra mbi të që ta drejtonte. Nuk e ep arësye pse ky projekt ishte shkue "tutto a fumo". Sigurisht fjala asht për një shoqni si ajo e Bashkimit, në të cilën Mjedja ma vonë pat një rol me randësi.

Letra e tretë e dërgueme gjithnji nga Portorë përmban një falnderim të përzemërt për dërgesën e Meyer-it të vëllimit të IV të Albanesische Studien. Shkruen se e ka këndue veprën disa herë. Me mendësinë e një dijetari të vërtetë nuk rrin tue lëvdue auktorin, por në një mënyrë të njerzishme ven në dukje se në Shkodër nuk thonë dretë (dreç), por dreç. Mjedja mendon se ç e q ortografikisht ngatrohën në Shkodër, por e vërteta asht se ç e q në shumë të folme të kësaj krahine janë shkri ase kanë ra në një fonem (q ase ç), prandaj nga kjo rrjedh se dhe në shkrim ngatrohën geramat në fjalë.

Mjedja ven me të drejtë në dukje se prania e o-s në vend të u-s asht një karakteristikë e të folmeve lindore geqe: në Prizrend thohet odhë në vend të udhë si dhe dokem në vend të dukem. Trajta të tilla djalektore kanë shty dhe Jokl-in të bijë përcaktime të gabueshme mbi shtresat e fjalëve latine në shqipe (Balkan-Archiv, IV 196), që Çabej mandej me të drejtë e kundërshton tue pru faktin se kemi të bajmë me

varianta djalektore (krh. Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwörter im Albanischen, në "Revue de Linguistique", VII – 1 (1962) fq. 164). Mjedja i propozonte Meyer-it që në rasë se donte të bante një botim të dytë të fjalorit etimologjik, ishte gadi t'i dërgonte dhe informata tjera mbi të folmet e Shkodrës, sepse trajtat e kësaj ane nuk kanë qenë të riflektueme drejt nëpërmjet të ortografisë së Propagandës në përdorim.

Poeti lyp lajme prej Meyer-it dhe rreth levizjes kulturore të arbreshëve të Kalabrisë me në krye De Radën. I ka ra në vesh se atje ishte themelue një shoqni për zhvillimin e studimeve rreth gjuhës shqipe. Albanologu Meyer i ndoq kambë për kambë të gjitha levizjet shqiptare të Rilindasve tonë. Mun ai u ba vetë trumbetues i këtyne përpjekjeve tue shkruar dhe në gazeta mbi gjallninë e intelektualëve shqiptarë. Poeti ynë don që dijetari austriak të vejë dorë dhe të mbarojë një gramatikë krahasuese të shqipes: ai këtë e lyp në shumë letra me kryeneçsi, sepse një vepër të tillë ky e sheh të nevojshme "për lumninë e Shqipnisë" sepse tue i tregue botës randësinë e shqipes në gjuhësinë krahasuese indoeuropiane, Mjedja e din se shkon në të mirë të çlirimit të popullit shqiptar dhe trajtimit të një shteti në vete. Ky asht piksynimi i Rilindasve dhe për këtë qëllim punojnë e shkruajnë si Mjedja, Mitko, etj.

E rrallë

Zbulimi në Australi, njerëzit kultivonin banane që 2 000 vjet më parë



Arkeologët kanë zbuluar në Australi një fermë antike bananesh që mendohet se kultivohej nga indigjenët australianë. Sajti daton 2 145 vjet më parë dhe është gjetur në një ishull të vogël. Kërkuesit kanë zbuluar

mikrofosile, vegla guri, qymyr druri dhe disa reshta muresh mbajtëse. Ky zbulim hedh poshtë mitin e krijuar se vendasit në Australi ishin gjuetarë. Kërkimi është kryer nga një epik i përbërë nga Universiteti

Kombëtar i Australisë dhe Universiteti i Sydney. “Kërkimi ynë tregon se të parët ishin të përfshirë në kultivimin e praktikave të kopshtarisë rreth 2 000 vjet më parë”, ka thënë drejtuesi i kërkimit Rober Williams.

BARSOLETA E DITËS



Mësuesja: Unë studioj, ti studion, ai/ajo studion. Çfarë kohe është Toni? Toni: Është kohë e humbur kot, mësuese!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



FOTO E DITES



Pamje nga Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, burim historik dhe trashëgimi kulturore shqiptare. /LSA/

E jashtëzakonshme

Argjendaria izraelite po krijon maskën 1.5 mln dollarë me mijëra diamante

Një argjendari izraelite po krijon maskën anti Covid më të shtrenjtë në botë që ka vlerën 1.5 milion dollarë me plot 3 608 diamante. Mësohet se një grup prej 25 argjendarësh dhe personash të tjerë që punojnë me diamante po punojnë me turne për ta përgatitur porosinë deri më 31 dhjetor të këtij viti. Sikurse raportohet nga mediat e huaja, argjendaria po e bën këtë maskë me

kërkesë të një klienti miliarder nga Shanghai. “Maska do të ketë 250 gramë ar 18 karatësh, i vendosur me jo më pak se 3 608 diamante natyrore dhe e pajisur me një filtër N-99”, është shprehur Sharon Caro, një përfaqësues për markën luksoze “Yvel”. Disenjatori Isaac Levy ka argumentuar se kjo porosi është duke e shtyrë atë dhe bashkëshorten Orna që ta vazhdojnë biznesin e tyre.

<p>DASHI Tre ditët e ardhshme janë për t'iu kushtuar miqësisë, jetës shoqërore dhe realizimit të një projekti të shkëlqyer. Nëse jeni në çift do të keni mundësi të kuptoni aspektet më të mira të marrëdhënies.</p>	<p>DEMI Marrëdhënia në çift mund të arrijë nivele të larta erotike, të kënaqshëm dhe intrigues. Ndikimet e yjeve ju ngarkojnë me energji pozitive dhe do jeni vigjilent në çdo gjë që bëni.</p>	<p>BINJAKËT Edhe pse jeni në kohë pushimesh, do jetë një periudhë plot ide dhe mundësi të mira profesionale për ju. Ditë ideale për të bashkëpunuar me jashtë dhe me njerëz që jetojnë larg vendbanimit tuaj.</p>	<p>GAFORRJA Nuk ka asnjë pengesë nëse keni vendosur ta kaloni atë me njerëzit që doni. Nëse dëshironi të fantazoni dhe argëtoheni, kërkoni për dikë që i përket shenjës së Demit.</p>	<p>LUANI Yjet ju japin një besim të veçantë brenda vetes tuaj dhe ndjeshmëri për ta përdorur atë. Ju keni sasinë e duhur të sigurisë në organizimin dhe funksionimin.</p>	<p>VIRGJËRESHA Ata që kanë vendosur të qëndrojnë me njerëz rreth e rrotull, do përballen me aventura momentale dhe kënaqësi. Ju do e dini se si të përfitoni nga mundësitë falë një ndjeshmërie të veçantë që keni.</p>
<p>PESHORJA Mendja e qartë, perspektiva, intuita dhe krijimtaria ekspresive janë disa nga cilësitë që yjet i ju ofrojnë në këto ditë të gushtit. Në sektorin e dashurisë do keni marrëveshje të mira me partnerin.</p>	<p>AKREPI Sot do keni ndikime ideale për të bërë një ndryshim vendimtar dhe për të zgjidhur çështje që lidhen me një trashëgimi. Do jeni në gjendje të rifreskoni veten fizikisht dhe shpirtërisht.</p>	<p>SHIGJETARI Ju mund të bëni atë që dëshironi pa asnjë problem dhe pengesë. Nëse ka ndonjë mosmarrëveshje, ndoshta për shkak të një ndryshimi të planeve gjatë ditës, bëni kujdes me fjalët.</p>	<p>BRICJAPI Ende është një ditë pozitive, në të cilën ju mund të kanalizoni energjitë tuaja në të gjithë sektorët ekzistencialë që dëshironi, por ajo sentimentale është ajo që merr mbështetjen më të mirë.</p>	<p>UJORI Nga sot deri të premtën, do jetë koha ideale për të shprehur dëshirat që keni në lidhje me partnerin që dashuron. Energji e mirë për të rigjallëruar një marrëdhënie në çift.</p>	<p>PESHQIT Do jetë një ditë e gëzueshme, do zgjedhjet tuaja do jenë të duhurat. Kudo që të jeni, me pushime, në udhëtime apo brenda në qytet, ju do takoni një person që do ju rrahë zemra fort.</p>

Miliarderja feston 23-vjetorin e lindjes, zbulon dhuratën më të bukur

Miliarderja Kylie Jenner ka festuar ditëlindjen e 23-të. Pasi i ka shprehur mirënjohjen dhe falënderimin fansave për mbështetjen, ylli i "Keeping Up With The Kardashians" ka zbuluar edhe dhuratën më të bukur që ka marrë në ditën e saj të veçantë. Kylie publikoi një foto me vajzën e saj Stormi, ku kjo e fundit shfaqet duke fryrë qirinjtë e tortës së mamasë, ndërkohë që Jenneri e përqafo. "Dhurata më e bukur nga të gjitha", ka shkruar 23-vjeçarja në llogarinë e vet në "Instagram".



Maura simpatike shfaqet e nxehtë në Kreta



Maura Higgins ka treguar asetet nga pushimet në Kretë, kurse e njohura nga "Love Island" "ia ka bërë unfollow" ish të dashurit Curtis Pritchard pas puthjes së tij me Amber Pierson. Kohët e fundit ajo e ka cilësuar Curtis Pritchard si "një bataçqi" kur ka mësuar romancën e re të valltarit me

Amber Pierson. Maura Higgins nuk është marrë me këtë dramë derisa ajo ka treguar gjoksin dhe asetet në bikini, derisa po kalon pushimet në Kretë të Greqisë. Ylli i "Love Island" (29) është parë duke marrë diell në bikini, kurse që mos të shqetësohet fare për të kaluarën nuk e përcjell më në asnjë rrjet social ish të dashurin e saj.



Sara shfaqet e mahnitshme në veturë me Ledrin: Unë vozis kur ai pi

Sara Hoxha tashmë është bërë shumë e dashur për publikun shqiptar. Ajo ushtron profesionin e blogurës, ndërsa më e njohur është bërë edhe nga lidhja e saj me reperin Ledri Vula. Tashmë bukuroshja brune ka filluar të jetë edhe më aktive në rrjete sociale, duke publikuar kështu imazhe nga përditshmëria. Në një postim

në rrjetin social "Instagram", Sara ka pozuar nga një makinë luksozë teksa ishte veshur plot stil. Me një fustan të zi dhe të ngushtë, dukjes ajo i ka bashkangjitur edhe një grim të rëndë, që e bënte edhe më tërheqëse. "Unë vozis kur ai pi, por prapëseprapë duhet të më bëjë fotografi", ka shkruar ajo në përshkrim të fotografisë.

Më e mirë në shtrat Angelina apo Jennifer: Brad Pitt jep këtë përgjigje

"Angelina apo Jennifer?", është pyetja që i është bërë kaq shumë herë aktorit 56-vjeçar Brad Pitt, i cili kurrë nuk ka dashur t'i zbulojë sekretet nga dhoma e gjumit. Por, sipas një burimi të afërt me aktorin që zbuloi një "sekret të ndyrë" për mediat amerikane, Brad ishte akoma më emocionues në shtrat me 51-vjeçaren Jennifer Aniston. "Ai gjithsesi e pranoi se ishte Jennifer dhe ai ishte më i qetë me të, domethënë që kishte më shumë pasion. Megjithëse përmendi që ishte në të njëjtën gjë me Jolie në fillim, mirëpo gjërat ndryshuan më vonë, dhe Angelina kinse nuk donte të flinte me të më shumë se një ose dy herë në javë.



Brad madje zbuloi se Jenniferi është personi më i qetë me të cilin ka fjetur ndonjëherë dhe se gjithnjë është tërhequr nga fakti që ajo është me plot vetëbesim dhe e gatshme për gjëra të reja", ka thënë një burim i afërt me të. Sipas tij, Bradi ka thënë se Aniston pothuajse asnjëherë nuk refuzoi dhe se ajo ishte gjithmonë në humor për "lojëra të nxehta".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**



Shtyhet vendimi për ndeshjen finale Drita - Linfield

Ndeshja e anuluar finale e raundit preliminar në Ligën e Kampionëve në mes të Dritës dhe Linfieldit nuk dihet se kur do të zhvillohet, pasi vendimi është dërguar në instancën e Apelit të UEFA-s. Data e vendimit nuk është bërë me dije, kurse klubi kampion është rikthyer të mërkurën në Kosovë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 GUSHT - Skuadra e Dritës nga Gjilani të mërkurën është rikthyer në Kosovë. Skuadra gjilanase që e fitoi gjysmëfinalen e raundit preliminar në Ligën e Kampionëve është dashur të martën të përballet në finalen me klubin irlandez Linfield, por kjo ndeshje u anulua nga autoritetet zvicerane për shkak të virusit Korona. Skuadra e Dritës ka njoftuar se vendimi

për këtë ndeshje është shtyrë dhe kalon në një instancë tjetër, derisa nuk është bërë me dije se kur do të merret vendimi final. "Ka përfunduar mbledhja e mbajtur nga komisioni disiplinor për rastin e ndeshjes së anuluar të klubit tonë me ekipin e Linfield FC. Komisioni i disiplinës, në bazë të argumenteve dhe rrethanave të krijuara për këtë takim, nuk ka mundur të vendosë dhe këtë çështje e ka drejtuar në instancën e Apelit të UEFA-s. Në vendim thuhet: 'Duke pasur

parasysh rrethanat urgjente të kësaj çështje, të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në drejtimin më të lehtë të Ligës së Kampionëve të 2020/21 UEFA dhe bazuar në nenin 29 (3) të Rregullores së Disiplinës të UEFA-s, dëshiroj t'ju informoj se unë kam vendosur që këtë çështje t'i drejtohem direkt Organit të Apelit të UEFA-s për një vendim'. Data e vendimit nga organet e Apelit të UEFA-s nuk është bërë me dije", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës.

SHKURT

Hila paraqitet te Gjilani

Skuadra e Gjilanit ka siguruar shërbimet e mesfushorit nga Elbasani, Ardit Hila. 27-vjeçari karrierën e futbollit e nisi në qytetin e lindjes, KF Elbasani. Ai ka bërë karrierë në Shqipëri dhe në skuadrën e Teutës dhe të Partizanit, kurse kampionatin e fundit ishte pjesë e Prishtinës. "Ardit Hila në skuadrën e Gjilanit vjen pas një viti të kaluar te ajo e Prishtinës, nga ku ishte paraqitur në 15 takime. Mesfushori 27-vjeçar me skuadrën e Gjilanit ka firmosur kontratë, e cila do ta mbajë atë si pjesë e ekipit kuq e bardh për një edicion", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.

Ajeti, afër huazimit në Celtic

Albian Ajeti pritet që ta kompletojë përfundimisht transferimin te Celticu për 5 milionë funte dhe jo në formë huazimi. "Record Sport" mëson se 23-vjeçari shumë shpejt pritet t'i bashkohet ekipit në qendrën stërvitore në "Lennoxton". Neil Lennon dhe shefi ekzekutiv Peter Lawwell e kanë kaluar të martën duke u mundur ta bindin sulmuesin shqiptar t'i bashkohet klubit dhe një gjë e tillë thuhet se ka përfunduar. Ajeti që luan edhe me Zvicrën, nga Baseli kaloi te West Hami. Në 15 ndeshje të edicionit të kaluar ka shënuar dy gola.

Matudi largohet nga Juventus

Blaise Matuidi edhe zyrtarisht e ka shkëputur kontratën me Juventusin me marrëveshje të dyanshme dhe tani pritet t'i bashkohet klubit të MLS-së, Inter Miami. 33-vjeçari iu bashkua Juventusit nga PSG-ja në verën e vitit 2017 për 25 milionë euro. Ai pritet të transferohet te klubi amerikan Inter Miami, i cili drejtohet nga David Beckham. "Mesfushori francez largohet nga Juventus pas tri vjetësh dhe pesë titujve të fituar në klub. Me ngjyrat tona në shpinën e tij, ai luftoi dhe luajti me zemër në çdo ndeshje. Matuidi i jep lamtumirën Juventusit me marrëveshje të përbashkët", thuhet në njoftimin e Joves.

Hila paraqitet te Gjilani

Gjilan, 12 gusht - Skuadra e Gjilanit ka siguruar shërbimet e mesfushorit nga Elbasani, Ardit Hila. 27-vjeçari karrierën futbollistike e nisi në qytetin e

lindjes, KF Elbasani. Ai ka bërë karrierë në Shqipëri dhe në skuadrën e Teutës dhe të Partizanit, kurse kampionatin e fundit ishte pjesë e Prishtinës.

"Ardit Hila në skuadrën e Gjilanit vjen pas një viti të kaluar te ajo e Prishtinës, nga ku ishte paraqitur në 15 takime. Mesfushori 27-vjeçar me

skuadrën e Gjilanit ka firmosur kontratë, e cila do ta mbajë atë si pjesë e ekipit kuq e bardh për një edicion", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.



Gara e Formulës 1 në Sochi, e hapur për publikun

SOCHI, 12 GUSHT - Ndërkohë që organizatorët e Çmimit të Madh të Italisë në Formula 1 po punojnë që gara e Mugello, më 13 shtator, të zhvillohet me publik, nga Rusia vjen lajmi se gara e Sochit, e cila zhvillohet më

27 shtator, do të jetë e hapur për fansat e këtij sporti. Organizatorët e garës ruse synojnë që ta afrojnë publikun në 50 % të kapacitetit, pra 30 mijë spektatorë. Deri më tani të gjitha garat e zhvilluara kanë qenë pa

publik, por në Rusi ka nisur zyrtarisht shitja e biletave për garën e Sochit. Në pistën e Sochit do të zhvillohet gara e 10-të sezonale e Formula 1, një kampionat që nisi vetëm një muaj më parë, për shkak të pan-

demisë së Covid-19. "Spektatorë do të ketë gjatë provave dhe garës, por ata do ta zbatojnë protokollin e sigurisë. Nuk do të ketë ngjarje me pilotët, shëtitje etj", kanë thënë organizatorët e garës së Sochit.



Llapi angazhon trajner nga Afrika e Jugut

Llapi e ka marrë në përfundim trajnerin Alan Clark i cili do të jetë ndihmësi i parë i trajnerit Tahir Batatina në edicionin 2020/2021, ndërsa në skuadrën nga Podujeva është rikthyer mesfushori Kushtrim Shabani i cili edicionin e fundit luajti për Gjilanin

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 12 gusht - Skuadra e Llapit po vazhdon përfundimet për kampionatin e ri 2020/2021. Kjo skuadër ka sjellë një risi në futbollin e Kosovës, pasi ka angazhuar trajnerin nga Afrika e Jugut, Alan Clark. Ky i fundit do të jetë ndihmësi i trajnerit Tahir Batatina. "KF Llapi ka kënaqësinë t'jua prezantojë anëtarin më të ri të klubit, asistentin e parë të shtabit teknik Alan Clark. Clark me të mbërritur në kampin llapjan është njoftuar me projektin dhe së bashku me trajnerët e tjerë iu kanë përveshur punës për ta përgatitur skuadrën në mënyrën më të mirë për edicionin e ri të Superligës", thuhet në njoftimin e Llapit.

40-vjeçari i lindur në Evendale të Afrikës së Jugut është i pajisur me licencën UEFA Pro, Clark ka punuar në skuadrën e Mamelodi Sundowns FC si trajner i kategorive të reja. Më pas punoi



si asistent i parë i shtabit teknik në skuadrën e SuperSport United, të Përfaqësuesja e Kosovës U21, të cilët kishte edhe rolin e trajnerit analist si dhe tek AmaZulu FC, kurse së fundmi ishte trajner i parë i skuadrës Black Leopards FC, ku drejtoi këtë skuadër në 8 ndeshje të edicionit pranveror. Kjo nuk është risia e vetme e skuadrës së Llapit, pasi në 241 orët e fundit ky klub ka arritur marrëveshje edhe me

mesfushorin Kushtrim Shabani, i cili rikthehet në skuadrën nga Podujeva pas një aventure që kishte në skuadrën e Gjilanit. "Pas një viti e gjysmë të kaluar te skuadra e Gjilanit, mesfushori llapjan Kushtrim Shabani është rikthyer në klubin ku u rrit dhe u bë i njohur. Me përfundimin e kontratës me Gjilanin, Kushtrim Shabani nuk mendoi dy herë dhe iu rikthye skuadrës së Llapit", thuhet në njoftimin e Llapit.

Lillard shënon 61 pikë në suksesin e Portlandit, Milwaukee rikthehet te fitorja

ORLANDO, 12 GUSHT - Në "The Arena" të Orlandos u zhvillua një nga sfidat më spektakolare në NBA, ku përballë u vunë Dallas Mavericki dhe Portland Trail Blazersi, ndërsa në fund "buzëqeshën" këta të fundit që arritën të fitojnë me shifrat 131-134. Damian Lillard ishte fantastik në këtë sfidë, pasi arriti të shënojë plot 61 pikë, ose 45.5 % të totalit të pikëve të shënuar nga Trail Blazersi, ndërsa ia doli t'i rikuperojë 5 topa dhe të japë 5 asistime, duke kompletuar një mbrëmje magjike. Portlandi mori kontrollin e lojës që në fraksionin e parë, të cilin e fitoi me 7 pikë diferencë, ndërsa reagimi i Dallasit në pjesën e tretë të ndeshjes vetëm sa rihapi takimin, pasi nuk ndryshoi dot fatin e tij. Kjo ishte fitorja e dytë radhazi për Portland Trail Blazersin që ruan pozitën në zonën "play-off" në renditjen e Konferencës së Perëndimit, ndërsa Dallas Mavericki pëson humbjen e dytë në 5 sfidat e fundit të zhvilluara. Po në të njëjtin parket Sacramento



Kingsi triumfoi me shifrat 112-106 përballë New Orleans Pelicansit. Të udhëhequr nga Harrison Barnes, që shënoi 25 pikë, rikuperoi 8 topa dhe dha dy asistime, Kingsi ndali serinë prej dy humbjeve radhazi dhe iu largua disi fundit të tabelës së renditjes. Në Konferencën e Lindjes kryesuesit e Milwaukee Bucksit vinin pas dy humbjeve radhazi, që gjithsesi nuk ua

rrezikonin vendin e parë, por ia dolën të reagojnë dhe të fitojnë me shifrat 113-116 përballë Washington Wizardsit. Brook Lopez dhe Sterling Browni ishin protagonistët e suksesit të Milwaukee Bucksit, që dominoi në tri fraksionet e para të lojës dhe lëshoi disi në pjesën e fundit, por pa vënë për asnjë çast në diskutim fitoren përballë Wizardsit.

SHKURT

Edhe Rogova largohet nga Besa

Pas Florim Bërbatovcit, edhe një futbollist i njohur e ka zyrtarizuar ndarjen me skuadrën e Besës së Pejës. Bëhet fjalë për sulmuesin Dardan Rogova, i cili në të kaluarën kishte bërë karrierë edhe në skuadrën e Vëllaznimit. "Ju njoftoj se nuk do të jem me pjesë e klubit KF Besa, pas një viti të suksesshëm me rastin e hyrjes në Superligë. Faleminderit kryesisht, shtabit teknik dhe të gjithë bashkëlojtarëve për këtë vit të kaluar së bashku, ndërsa klubit i dëshiroj suksese në Superligë", ka shkruar Rogova në profilin e vet në "Facebook".

151 futbollistë infektohen me Covid-19 në Brazil

Koronavirusi po bën kërdinë në Amerikën Latine. Brazili është shteti i dytë më i prekur në botë nga pandemia pas ShBA-së. Mbi tre milionë brazilianë janë infektuar nga Covid-19, teksa mbi 103 mijë njerëz kanë humbur jetën. Pozitivë kanë rezultuar edhe shumë futbollistë. Kampionati nisi javën e kaluar, saktësisht tre muaj e gjysmë me vonë. Shifrat janë të frikshme dhe Tyc Sports raporton se plot 151 futbollistë janë prekur nga pandemia deri tani. Klubit më të goditura janë Corinthians dhe Goias me nga 23 raste, ndjekur nga Vasco Da Gama me 22 raste, ndërsa më pas vijnë Botafogo me 20 dhe Flamengo me 15 persona të infektuar.

Një futbollist i Barçës rezulton pozitiv me Covid-19

Skuadra e Barcelonës ka njoftuar se pas testeve të kryera në një grup prej nëntë futbollistëve që kishin filluar përgatitjet parasezonale, një prej tyre ka dalë pozitiv. Ai nuk do të udhëtojë me skuadrën në Lisbonë për fazën finale të Ligës së Kampionëve. Futbollisti, emri i të cilit nuk është zbuluar, është asimptomatik dhe pa probleme shëndetësore. Bëhet fjalë për të rinjtë e ardhur nga skuadra e dytë: Pedri, Trincao, Matheus Fernandes, Todibo, Wague, Alena, Rafinha, Miranda dhe Oriol Busquets. Futbollisti që, pas analizës për koronavirus, ka dalë pozitiv, nuk ka qenë në kontakt me anëtarët e ekipit të parë që do të udhëtojnë drejt Lisbonës të enjten për t'u përballur me Bayern Munich. Pas mbërritjes në stërvitje, lojtarët duhet t'i nënshtroheshin një testi tjetër PCR për t'i përjashtuar pozitivët e mundshëm.

Martinezi kërkon të largohet nga Bayerni

Javi Martinez po kërkon të largohet nga Bayern Munich pas tetë vjetësh me klubin gjerman, ka konfirmuar shefi ekzekutiv Karl-Heinz Rummenigge. Mesfushori 31-vjeçar u bashkua me Bayernin nga Athletic Bilbao më 2012 dhe ka fituar 19 trofe gjatë kohës së tij në 'Allianz Arena'. Sidoqoftë, Martinezi ka startuar vetëm 10 herë në të gjitha garat në 2019/20 dhe së fundmi ka hyrë në 12 muajt e fundit të kontratës së tij. "Ne e dimë se ai do të donte të largohej nga klubi me një ofertë të përshtatshme", ka thënë Rummenigge. "Ne nuk do të vendosim pengesa në rrugën e tij sepse ai ishte gjithmonë një lojtar i mirë dhe një person i besueshëm, serioz. Ne gjithmonë do të përpiqemi të gjejmë një zgjidhje që i përshtatet lojtarit", ka deklaruar Rummenigge.



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/736

Më: 12.08.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2020/2021

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Gjergj Fishta" në Senik	Gjeografi 9 orë, edukatë qytetare 5 orë	Vendi i lirë	1	14

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Certifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr 04/L-032 dhe , Ligji Nr. 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës Gjeografi kërkohet kualifikimet: **Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Baçelor katërvjeçar (240 ECTS).**

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës edukatë qytetare kërkohet programi i mësimdhënies Histori- edukatë qytetare ose Gjeografi -edukatë qytetar; kualifikimet: **Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Baçelor katërvjeçar (240 ECTS).** Ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe testit me gojë sipas nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **12.08.2020 deri më datën:26.08.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "DEUTSCHER PARTNER", SH.P.K. me pronar Irfan Veseli e Mehmet Zylfiu nga Gjilani kanë marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 810066929, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "DEUTSCHER PARTNER" D.O.O. sa vlasnikom Irfan Veseli e Mehmet Zylfiu iz Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810066929, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "DEUTSCHER PARTNER" L.L.C. the owner Irfan Veseli e Mehmet Zylfiu in Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810066929 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "A&I-Oil" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810031063.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrje publike Nr.03/L-087, Kodit të etikës dhe qeverisjes korporative mbi Ndërmarrjet Publike, statutit të Kompanisë dhe rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Drini i Bardhë" Sh. A, me datën 12.08.2020 vendosi të shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

1. Zyrtar ligjore i Kompanisë

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv.

Vendi i Punës: Pejë. Një pozite (1).

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e emërimit: me kohe të pacaktuamë me pune provues prej gjashtë (6) muaj.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Detyrat e punës:

Përpilon të gjitha paditë, kërkesëpaditë, kërkesat për ekzekutimin e Aktgjykimeve dhe aktvendimeve Gjyqësore të Enteve dhe Institucioneve tjera, Përpilon të gjitha ankesat kundër aktvendimeve dhe aktgjykimeve, Përpilon para projektet e akteve normative të Kompanisë, Përpilon kontratat e punës më të punësuarit, Përpilon kontratat e ndryshme më operatorët ekonomik të cilët marrin shërbime ose mallra nga Kompania, Sipas autorizimit përfaqëson Kompaninë në Gjykata. Përpilon rregulloret e Kompanisë, Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës janë:

-Fakulteti juridik drejtimi i përgjithshëm,

-Përvoja e punës prej 2 vjet në profesion.

-Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

-Njohja e punës më kompjuter programet,,Word,,Excel,etj.

-Vendimin për themelimin e marrëdhënies së punës e benë Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë.

- të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit për pozitën e Zyrtarit ligjore duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

Kërkesën,
CV-ne (Biografinë),
Kopjen e letërnjoftimit,
Letër motivimin,
Deklaratën nën betim,
Diplomën e fakultetit Juridik – kopje të Noterizuar,
Certifikatë që nuk është nën hetime dhe
Dëshminë e përvojës së punës.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim për pozitën e zyrtarit ligjor: Sipas këtij konkursi kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura për aplikim:

Aplikacionet e kompletuara sipas këtij konkursi dërgohen në Zyrën e Asistentes Administrative NP. K.R.U "Drini i Bardhë" SH.A në adresën Rr." Mbretëresha Teutë" Nr.85 Pejë, konkursi është i hapur nga data e publikimit në gazetë, aplikacionet mund të dorëzohen nga ora 8:00 deri në ora 16:00.

Paraqitja e kërkesave:

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova, Sh.A, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall:

KONKURS

Titulli i Pozitës- Zyrtar/e Për Projektim dhe Zhvillim

Numri i pozitave: 2 (dy)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :

- Ndihej në hartimin e projekteve për zgjerimin e rrjetave të reja në KRU "Gjakova" Sh.A.
- Ndihej në hartimin e projekteve për ndërtimin e objekteve të reja hidrondertimore në KRU "Gjakova" Sh.A.
- Ndihej në hartimin e projekteve mbi mirëmbajtjen dhe reabilitimin e sistemeve egzistuese të rrjetit të ujësjellësit
- Ndihej në zbatimin dhe zhvillimin e projekteve të kompanisë;
- Ndihej në mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave të projekteve të kompanisë;
- Ndihej në dorëzimi në kohë dhe cilësia e raporteve të aktivitetit sektorial të kompetencës.
- Ndihej në përmirësimin e sektorit të zbatimit të projekteve të KRU Gjakova;
- Ndihej në menaxhimin, përditësimin e bazës së të dhënave të projekteve të kompanisë në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Kryen detyrat e dhëna në kohë dhe mënyrë profesionale;
- Ndihej në zhvillimin dhe mbajtjen e standardeve të qëndrueshme për raportimin e statusit të projektit .
- Ndihej në sigurimin dhe respektimin e standardeve të cilësisë dhe rishikimit të rezultateve të projektit sipas detyrës dhe kompetencës;
- Ndihej dhe ruan dokumentacionin dhe procedurat e sakta dhe të plota të identifikuara për të gjithë projektin (hapat) në lidhje me funksionalitetin apo cilësitë respektive;
- Ndihej në projektimin, incizimin dhe regjistrimet e aseteve deri në vlerësimin e gjendjes
- Si dhe detyra tjera të punës të caktuara nga punëdhënësi

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.

- Përgatitja profesionale/Shkollore- Fakultetin e Ndërtimtarisë, Drejtimi- Hidroteknike/Konstruktiv.
- Preferohet përvoja e punës 2 vjeçare që ndërlihet me pozitën apo të ngjashme.
- Aftësi të mira organizative dhe koordinuese.
- Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit.
- Njohja e punës me kompjuter (Microsoft office)
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Informata të përgjithshme :

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim- Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3.CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit(kopja e noterizuar), si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkurrimit është nga data: 13/08/2020 deri me 27/08/2020. Adresa e zyrës Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë-Kosovë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

